



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.31

25 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 079
datë 23.2.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e programit “Malet drejt tregut”” 1745

Ligj nr.10 080
datë 23.2.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) dhe KFW-së, Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi për furnizimin me ujë të zonave rurale (faza 2)”” 1757

Ligj nr.10 081
datë 23.2.2009

Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë 1763

LIGJ
Nr.10 079, datë 23.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR (IFAD) PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “MALET DREJT TREGUT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e programit “Malet drejt tregut”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6086, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJA E FINANCIMIT TË PROGRAMIT

(Programi i Malet drejt tregut)
ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor

Marrëveshja e financimit të programit e datës _____ ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor (“Fondi”).

Ndërsa,

A) Huamarrësi ka kërkuar një hua dhe një grant, sipas përkufizimit në seksionin 2.02 këtu nga Fondi për qëllimin e financimit të programit të përshkruar në programin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Programi”);

B) Huamarrësi dhe Fondi kanë rënë dakord për planin e prokurimit për tetëmbëdhjetë muajt e parë të programit, dhe

C) Programi do të administrohet dhe mbikëqyret drejtpërdrejt nga Fondi.

Ndërsa, në bazë të konsideratave të mësipërme dhe të tjera, Fondi ka rënë dakord t’i japë një hua dhe një grant Huamarrësit me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje, kështu palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Seksioni 1.01 Kushte të përgjithshme. a) Kushtet e përgjithshme të Fondit për Financimin e Zhvillimit Bujqësor të datës 2 dhjetor 1998, që mund të ndryshohen herë pas here (“Kushtet e përgjithshme”) i janë bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje, dhe të gjitha dispozitat e saj (të përmendura shprehimisht këtu ose jo) janë bërë pjesë përbërëse e kësaj. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është në mospërputhje me kushtet e përgjithshme, zbatohet dispozita e kësaj Marrëveshjeje, por asnjë dispozitë e kësaj nuk kufizon përgjithësimin e ndonjë dispozite të kushteve të përgjithshme.

b) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, kushtet e përgjithshme ndryshohen si më poshtë:

i) neni III shfuqizohet në tërësinë e tij;

ii) kur përdoret shprehja “Institucioni bashkëpunues”, “Fondi në konsultim me institucionin

bashkëpunues” dhe të gjitha shprehjet e ngjashme i referohen vetëm Fondit; dhe

iii) të gjitha referencat në kushtet e përgjithshme për “Institucionin bashkëpunues” konsiderohen t’i referohen Fondit.

Seksioni 1.02 Përkufizime. a) Kur përdoren në këtë Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në kushtet e përgjithshme dhe parathënien e kësaj Marrëveshjeje janë kuptimet përkatëse të përcaktuara atje.

b) Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje,

“ALL” ose “lek” është monedha e Huamarrësit;

“ADF” është Fondi Shqiptar i Zhvillimit;

“AWPB” është plani dhe buxheti vjetor i punës për realizimin e programit gjatë një viti të veçantë programi, sipas përshkrimit në seksionin 3.02.

“Ditë” janë ditët kalendarike gjatë një viti të programit.

“Datë e hyrjes në fuqi” është data që Fondi i dërgon njoftim Huamarrësit pas pranimit të tij që kushtet paraprase të përcaktuara në seksionin 7.01 janë përmbushur sipas bindjes së Fondit.

“Vit fiskal” është secila periudhë që fillon më 1 janar dhe që mbaron më 31 dhjetor.

“Norma e interesit të referencës IFAD” është norma e përcaktuar çdo vit nga Fondi si normë reference për llogaritjen e interesit mbi huatë në afate të ndërmjetme dhe afate të zakonshme.

“Agjencia Drejtuese e Programit” është MADA.

“Data e mbylljes së huasë” është data, gjashtë muaj pas datës së përfundimit të programit, ose një datë e tillë e mëvonshme për të cilën mund të bien dakord Fondi dhe Huamarrësi. Termi “Data e mbylljes së huasë” konsiderohet t’i referohet si huasë ashtu edhe grantit.

“Monedha e pagesës së shërbimit të huasë” është monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

“MADA” është Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore.

“MBUMK” është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

“Data e përfundimit të programit” është përvjetori i pestë i datës së hyrjes në fuqi ose një datë e mëvonshme për të cilën mund të bien dakord Fondi dhe Huamarrësi.

“Manualët e zbatimit të programit” është manuali i zbatimit të programit i përshkruar në paragrafin B2 të programit 3.

“Pala e programit” përfshin (por pa e kufizuar) Agjencinë e Drejtimit të Programit, institucionet financiare të pjesëmarrjes në program dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara, kontraktorët, furnitorët dhe konsulentët e kontraktuar në pajtim me programin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

“Plani i prokurimit” është plani i prokurimit të Huamarrësit që mbulon periudhën fillestare tetëmbëdhjetë mujore të zbatimit të programit, e përditësuar herë pas here në pajtim me seksionin 3.02(a) të kësaj Marrëveshjeje për të mbuluar periudhat pasuese tetëmbëdhjetëmujore.

“Viti i programit” është i) periudha që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe që mbaron në datën 31 dhjetor pasuese, dhe ii) secila periudhë pas kësaj që fillon më 1 janar dhe mbaron në datën 31 të parë ose në datën e përfundimit të programit.

“SDRMA” është programi për zhvillimin e qëndrueshëm në zonat malore rurale të financuara nga huaja IFAD (684-AL).

“Dollare amerikanë” ose “USD” është monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

c) Pa kufizuar termat ose përgjithësimin e seksionit 2.02 të kushteve të përgjithshme, termi “Dokumenti i huasë” konsiderohet gjithashtu t’i referohet atij dokumenti në lidhje me grantin.

Seksioni 1.03 Referencat dhe titujt. Përveç kur tregohet ndryshe, referencat në këtë Marrëveshje të nenet, seksionet ose programet u referohen neneve, seksioneve ose programeve të kësaj Marrëveshjeje. Titujt përshkruar të këtyre neneve, seksioneve dhe programeve jepen për lehtësi reference dhe nuk përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.04 Detyrimet e Huamarrësit. Huamarrësi është tërësisht përgjegjës ndaj Fondit për përmbushjen e rregullt dhe në kohë të detyrimeve që i janë caktuar atij, Agjencisë Drejtuese të Programit dhe palëve të tjera në program sipas kësaj Marrëveshjeje. Në masën që një palë në program gëzon personalitet juridik të ndarë nga Huamarrësi, çdo referencë tek një detyrim i kësaj pale në program në këtë Marrëveshje konsiderohet detyrim i Huamarrësit për të siguruar që kjo palë në program të përmbushë këto detyrime. Pranimi nga një palë në program i një detyrimi të caktuar asaj në këtë Marrëveshje nuk cenon përgjegjësinë dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj.

Neni 2

Financimi

Seksioni 2.01. Financimi. Fondi bie dakord t’i japë Huamarrësit një hua në shumën principale prej

pesë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë të Drejta të Veçanta Tërheqjeje (SDR 5 860 000) (“Huaja”) dhe një grant në shumën dyqind e gjashtëdhjetë mijë të Drejta të Veçanta Tërheqjeje (SDR 260 000) (“Granti”) së bashku me huanë “Financimi”) për qëllimin e financimit të programit.

Seksioni 2.02. Llogaritë e grantit dhe huasë dhe tërheqjet. Fondi hap një llogari huaje dhe një llogari granti në emër të Huamarrësit dhe krediton atje përkatësisht shumën e huasë dhe grantit. Huamarrësi mund të kërkojë tërheqjet nga llogaria e huasë dhe grantit herë pas here ndërmjet datës së hyrjes në fuqi dhe datës së mbylljes së huasë në monedha të ndryshme në lidhje me shpenzimet e përshtatshme dhe ndryshe në pajtim me programin 2 (Akordimi dhe tërheqja e shumave të huasë dhe grantit) dhe nenin IV (Llogaria e huasë dhe tërheqjet) dhe seksionin 6.02 (Monedhat për tërheqjet) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 2.03 Llogaria e veçantë. a) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por në asnjë rast më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi hap dhe mban pas kësaj në Bankën e Shqipërisë një llogari në USD për qëllimin e financimit të programit (“Llogaria e veçantë”). Llogaria e veçantë mbrohet ndaj kompensimit dhe konfiskimit sipas termave dhe kushteve të propozuara nga Huamarrësi dhe pranuar nga Fondi.

b) Pasi llogaria e veçantë të jetë hapur rregullisht, me kërkesën e Huamarrësit, Fondi bën një ose më shumë tërheqje deri në 750 000 USD në tërësi (“Akordimi i lejuar”) nga llogaria e huasë në emër të Huamarrësit dhe e depoziton këtë shumë në llogarinë e veçantë; megjithatë, me kusht që, nëse Fondi nuk bie dakord ndryshe, akordimi i lejuar kufizohet në një llogari të barasvlershme me 400 000 USD derisa shuma e përgjithshme e tërheqjeve nga llogaria e huasë plus shumën e përgjithshme të të gjitha detyrimeve të veçanta të prapambetura të marra përsipër nga Fondi në pajtim me seksionin 4.03 të kushteve të përgjithshme (Detyrime të veçanta nga Fondi) barazohet ose e kalon 500 000 SDR. Fondi e rimbush llogarinë e veçantë herë pas here me kërkesë, në pajtim me seksionin 4.08 të kushteve të përgjithshme (Llogaria e veçantë), me ato shuma minimale që Fondi mund ta përcaktojë duke njoftuar Huamarrësin.

c) Huamarrësi operon me llogarinë e veçantë në pajtim me seksionin 4.08 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 2.04 Llogaria bankare e grantit. a) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por në asnjë rast më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi hap dhe mban pas kësaj në Bankën e Shqipërisë një llogari në USD për qëllimin e marrjes së shumave të grantit. Llogaria bankare e grantit mbrohet ndaj kompensimit dhe konfiskimit sipas termave dhe kushteve të propozuara nga Huamarrësi dhe pranuar nga Fondi.

b) Që nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë së Drejtimit të Programit, mund të kërkojë tërheqjet paraprakisht nga llogaria e grantit gjatë periudhës së zbatimit të programit. Shumat e kërkuara në këtë mënyrë nuk e kalojnë shumën e shpenzimeve që janë përfshirë në AWPB për vitin përkatës të programit që duhet të financohet nga granti. Rimbushja dhe përdorimi i shumave të grantit nga llogaria bankare e grantit bëhet mbi bazën e AWPB-ve.

Seksioni 2.05. Përdorimi i shumave. Huamarrësi dhe secila palë e programit përdor shumat e huasë dhe të grantit përjashtimisht për financimin e shpenzimeve të përshtatshme në pajtim me këtë Marrëveshje dhe kushtet e përgjithshme.

Seksioni 2.06. Interesi. Huamarrësi i paguan Fondit interes për shumën principale të huasë së kërkueshme herë pas here me një normë sa gjysma e normës së interesit të referencës së IFAD-it, që paguhet çdo gjysmë viti në çdo 1 shkurt dhe 1 gusht në monedhën e pagesës së shërbimit të huasë.

Seksioni 2.07. Shlyerjet e shumës principale. Huamarrësi paguan shumën principale të kërkueshme të huasë në njëzet e nëntë (29) këste gjysmëvjetore të barabarta prej 195 334 SDR, që paguhet në çdo 1 shkurt dhe 1 gusht, duke filluar nga viti 1 shkurt 2014 dhe që përfundon në 1 shkurt 2028, dhe një kështë të fundit prej 195 314 SDR, që paguhet më 1 gusht 2028, në monedhën e pagesës së shërbimit të huasë.

Neni 3 Programi

Seksioni 3.01. Zbatimi i programit. Huamarrësi deklaron përkushtimin e tij për qëllimet dhe objektivat e programit sipas parashikimit në programin 1 dhe, për arritjen e këtyre qëllimeve dhe objektiveve, programi zbatohet në pajtim me këtë Marrëveshje, veçanërisht në pajtim me seksionin 7.01 të kushteve të përgjithshme, dhe veçanërisht në pajtim me AWPB-të, planin e prokurimit, manualin e zbatimit të programit dhe detyrimet kontraktuale të palëve në program.

a) Seksioni 3.02. Planet dhe buxhetet vjetore të punës dhe plani i prokurimit.. a) Agjencia Drejtuese e Programit përgatit një projekt AWPB për huanë dhe grantin për çdo vit të programit. Projektprogrami AWPB përfshin, ndërmjet të tjerash, një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të

planifikuara të programit të vitit të ardhshëm të programit, një planprokurimi për 18 muaj dhe burimet dhe përdorimet e fondeve për këto, bazuar në planet dhe buxhetet përkatëse të punës të përgatitur nga secila prej palëve në program.

b) Para çdo viti të programit, Agjencia e Drejtimit të Programit i paraqet Fondit një AWPB, në lidhje me komentet e veta, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para fillimit të vitit përkatës të programit. Nëse Fondi nuk komenton mbi projekt AWPB-në brenda 30 ditëve nga marrja, AWPB-ja konsiderohet të jetë i pranueshëm për Fondin.

c) Agjencia e Drejtimit të Programit e miraton AWPB-në kryesisht në formën e pranuar nga Fondi dhe Agjencia e Drejtimit të Programit i jep kopje të saj Fondit para fillimit të vitit përkatës të programit.

d) Nëse është e nevojshme, Agjencia e Drejtimit të Programit mund të propozojë rregullime në AWPB gjatë vitit përkatës të programit, që hyn në fuqi pas përmbyshjes së procedurave të përshkruara në (b) dhe (c) më sipër.

Seksioni 3.03 Llogaritë e programit. a) Menjëherë sapo të jetë e mundshme, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, me kërkesë të Agjencisë së Drejtimit të Programit hap dhe mban dy llogari rrjedhëse në një bankë tregtare të pranueshme për Fondin, një në USD ("Llogaria e programit A") dhe një në lek, ("Llogaria e programit B") për operacionet e programit. Llogaria e programit A përdoret për: i) marrjen në avancë e likuiditeteve nga llogaria e veçantë; ii) parafinancimin e llogarisë së programit B; (iii) realizimin e pagesave për realizuesit e shërbimeve dhe konsulentëve për shërbimet kontraktuale; dhe (iv) realizimin e pagesave për furnitorët dhe kontraktorët për mallrat, punët civile dhe shërbimet. Llogaria e programit B përdoret për: i) marrjen në avancë të likuiditeteve nga llogaria e programit A; ii) marrjen e kontributeve financiare komunitare për investimet në infrastrukturë; iii) realizimin e pagesave për realizuesit e shërbimeve dhe konsulentëve për shërbimet kontraktuale; dhe iv) realizimin e pagesave për furnitorët dhe kontraktorët për mallrat, punët civile dhe shërbimet; dhe v) realizimin e pagesave për personelin e zyrës kryesore të Agjencisë së Drejtimit të Programit dhe shpenzimet operative.

b) Menjëherë sapo të jetë e mundshme, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, me kërkesë të Agjencisë së Drejtimit të Programit hap dhe mban një llogari në USD ("Llogaria e grantit të programit") në një bankë tregtare të pranueshme për Fondin, që përdoret për shpenzimet e pranueshme që i përkasin grantit (Llogaria e programit A, Llogaria e programit B dhe Llogaria e Grantit të Programit quhen bashkërisht "Llogaritë e programit").

c) Huamarrësi autorizon dy përfaqësues të caktuar të Agjencisë së Drejtimit të Programit për të operuar me llogaritë e programit.

a) Seksioni 3.04 Disponibiliteti dhe kanalizimi i shumave të huasë dhe grantit dhe Fondet Homologe. a) Huamarrësi i vë në dispozicion shumat e financimit Agjencisë së Drejtimit të Programit në pajtim me AWPB-të për të realizuar programin.

b) Përveç shumave të financimit, Huamarrësi i vë në dispozicion Agjencisë së Drejtimit të Programit gjatë periudhës së zbatimit të programit fonde homologe nga burimet e veta në pajtim me procedurat e veta të brendshme të zakonshme për asistencën e zhvillimit

Për këtë qëllim, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MAFCP), bën alokime buxhetore për çdo vit fiskal të barabarta me fondet homologe që kërkojnë në AWPB për vitin përkatës të programit dhe ia vë në dispozicion këto alokime Agjencisë së Drejtimit të Programit në momentin e nevojshëm për të përmbyshur programin në pajtim me këtë Marrëveshje dhe manualin e zbatimit të programit.

Seksioni 3.05. Burimet shtesë. Përveç shumave të financimit, Huamarrësi i vë në dispozicion Agjencisë së Drejtimit të Programit, menjëherë sapo të jetë e nevojshme, ato fonde, mjete, shërbime dhe burime të tjera, që mund të kërkojnë herë pas here për të përmbyshur programin në pajtim me këtë Marrëveshje, dhe në pajtim me seksionin 7.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.06. Prokurimi. I gjithë prokurimi i financuar nga shumat e financimit realizohet në pajtim me programin 4.

Neni 4

Rishikimet dhe raportet e zbatimit

Seksioni 4.01. Monitorimi. Agjencia e Drejtimit të Programit ngre, menjëherë sapo të jetë e mundur, por asnjëherë më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, dhe pas kësaj mban një sistem të përshtatshëm për menaxhimin e informacionit në pajtim me "Udhëzimet për monitorimin dhe vlerësimin e programit" të fondit për t'i dhënë mundësi atij të monitorojë programin në pajtim me seksionin 8.02 (Monitorimi i zbatimit të programit) të kushteve të përgjithshme, bazuar në treguesit e rënë dakord

ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit dhe përfshin treguesin e kërkuar nga sistemi i menaxhimit të rezultateve dhe ndikimit të Fondit (RIMS).

Seksioni 4.02. Raportet e progresit. Agjencia e Drejtimit të Programit i paraqet Fondit raporte progresi gjysmëvjetore dhe vjetore mbi zbatimin e programit, siç kërkohej nga seksioni 8.03 (Raporte progresi) i kushteve të përgjithshme, jo më vonë se gjashtë jave pas përfundimit të secilës periudhë raportimi gjatë periudhës së zbatimit të programit. Përveç çështjeve të përcaktuara në seksionin 8.03, secili raport progresi detajon progresin dhe arritjet në lidhje me sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme dhe masave të përshtatshme operative.

Seksioni 4.03 Rishikimi afatmesëm. a) Agjencia e Drejtimit të Programit dhe Fondi realizojnë së bashku zbatimin e programit jo më vonë se 36 muaj pas datës së hyrjes në fuqi ("Rishikimi afatmesëm") bazuar në termat e referencës të përgatitura nga Agjencia e Drejtimit të Programit dhe rishikuar nga Fondi. Ndërmjet të tjerash, rishikimi afatmesëm shqyrton arritjen e objektivave të programit dhe kufizimet për të dhe rekomandon atë riorientim që mund të kërkohej për të arritur ato objektiva dhe hequr këto kufizime. Veçanërisht, rishikimi afatmesëm: i) mat progresin fizik dhe financiar kundrejt AWPB-ve; ii) shqyrton performancën dhe menaxhimin financiar të partnerëve të kontraktuar zbatues; dhe iii) realizon një vlerësim të efikasitetit të asistencës teknike dhe programeve të trajnimit.

b) Huamarrësi siguron që rekomandimet që rezultojnë nga rishikimi afatmesëm, të pranueshëm për Huamarrësin dhe Fondin, të zbatohen brenda afatit të përcaktuar për këtë dhe të pranueshëm nga Fondi. Është rënë dakord dhe kuptohet që këto rekomandime mund të rezultojnë në modifikime të dokumenteve të huasë ose anulimin e huasë.

c) Brenda kontekstit të rishikimit afatmesëm, Huamarrësi dhe Fondi bien dakord për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të CSF-së pas datës së përfundimit të programit.

Seksioni 4.04. Raporti i përfundimit. Huamarrësi i paraqet Fondit raportin e përfundimit të kërkuar nga seksioni 8.04 (Raporti i përfundimit) i kushteve të përgjithshme jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit të programit.

Seksioni 4.05. Vlerësimet. Huamarrësi dhe çdo palë në program ndihmon në të gjitha vlerësimet dhe rishikimet e programit që mund të kryejë Fondi gjatë periudhës së zbatimit të programit, që kërkohej nga seksioni 10.05 (Vlerësimet e programit) të kushteve të përgjithshme.

Neni 5

Raportimi financiar

Seksioni 5.01. Pasqyrat financiare. Agjencia e Drejtimit të Programit mban llogari dhe regjistra të veçanta dhe pas kësaj përgatit pasqyra financiare të konsoliduara për operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me programin, bazuar në pasqyrat financiare të përgatitura nga palët përkatëse në program, që kërkohej nga seksioni 9.02 (Deklaratat financiare) të kushteve të përgjithshme në lidhje me çdo vit fiskal dhe ia dorëzon këto pasqyra financiare Fondit brenda tre (3) muajve nga fundi i çdo viti fiskal.

a) Seksioni 5.02. Raportet e auditimit. a) Brenda 90 ditëve të vitit të parë fiskal pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi cakton, pas një procesi konkurrues transparent, auditues të pavarur të zgjedhur në pajtim me procedurat dhe kriteret e parashikuara në "Udhëzimet mbi auditimet e programit (për përdorim të Huamarrësit)" të Fondit, që mund të ndryshohen herë pas here, për të audituar pasqyrat financiare në lidhje me programin për vitin e parë financiar. Pas kësaj, menjëherë sapo të jetë e mundur, por jo më vonë se 90 ditë pas fillimit të çdo viti pasues fiskal, Huamarrësi i konfirmon Fondit emërimin e këtyre audituesve ose emëron auditues të rinj të pavarur për këtë vit fiskal në pajtim me këtë paragraf.

b) Auditimet për programin ndërmerren në pajtim me standardet ndërkombëtare mbi auditimin dhe "Udhëzimet mbi auditimet e programit (për përdorim të Huamarrësit)" të Fondit 2003, që mund të ndryshohen herë pas here, deri në datën e mbylljes së huasë në pajtim me seksionin 9.03 të kushteve të përgjithshme. Përveç raportit të auditimit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, audituesit japin: i) një mendim mbi pasqyrat e certifikuar të shpenzimeve, përdorimin e llogarisë së veçantë dhe të llogarisë bankare të grantit; dhe ii) një letër të veçantë për menaxhimin, që trajton përshtatshmërinë e sistemeve të llogarive dhe të kontrollit të brendshëm. Huamarrësi ia dorëzon dokumentet e mësipërme Fondit brenda gjashtë muajve nga fundi i vitit fiskal. Agjencia e Drejtimit të Programit i paraqet Fondit përgjigjen për letrën e menaxhimit të audituesve brenda një muaji nga marrja e saj.

Neni 6

Mjetet e Fondit

Seksioni 6.01. Pezullimi (a) Fondi mund të pezullojë, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga Llogaria e Huasë dhe Llogaria e Grantit, në pajtim me Seksionin

12.01 të Kushteve të Përgjithshme me zhvillimin e një prej rasteve të parashikuara atje ose nëse:

i) Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Drejtimit të Programit është hequr nga Programi pa pëlqimin paraprak të Fondit;

ii) Fondi, pas konsultimeve me Huamarrësin, ka vendosur që përfitimet materiale të Programit nuk arrijnë në mënyrë të përshtatshme Grupin e Synuar, ose nga kjo përfitojnë persona jashtë Grupit të Synuar në dëm të anëtarëve të Grupit të Synuar;

iii) Nga Manualët e Zbatimit të Programit, ose një dispozitë e tyre, është hequr dorë, është pezulluar, shfuqizuar, ndryshuar ose modifikuar pa pëlqimin paraprak të Fondit dhe Fondi ka vendosur që kjo heqje dorë, pezullim, shfuqizim, ndryshim ose modifikim ka patur ose mund të ketë një efekt negativ material mbi Programin;

iv) Nga Statuti i Agjencisë së Drejtimit të Programit ose një dispozitë e tij, është hequr dorë, është pezulluar, shfuqizuar, ndryshuar ose modifikuar pa pëlqimin paraprak të Fondit dhe Fondi ka vendosur që kjo heqje dorë, pezullim, shfuqizim, ndryshim ose modifikim ka patur ose mund të ketë një efekt negativ material mbi Programin;

v) Një autoritet kompetent ka ndërmarrë një veprim për shkrirjen e Agjencisë së Drejtimit të Programit ose pezullimin e operacioneve të saj, ose është nisur një veprim apo procedim për shpërndarjen e ndonjë aseti të Agjencisë së Drejtimit të Programit ndërmjet kreditorëve të saj;

vi) Një autoritet kompetent ka ndërmarrë një veprim për shkrirjen e Agjencisë së Drejtimit të Programit ose pezullimin e operacioneve të saj, ose është nisur një veprim apo procedim për shpërndarjen e ndonjë aseti të Agjencisë së Drejtimit të Programit ndërmjet kreditorëve të saj;

vii) Fondi i ka bërë njoftim Huamarrësit që në vëmendje të Fondit kanë ardhur deklarime të besueshme në lidhje me praktika korruptive ose mashtruese në lidhje me Programin dhe Huamarrësi nuk ka marrë masa të përshtatshme dhe në kohë për të trajtuar çështjet në mënyrë të pranueshme për fondin; dhe

viii) Prokurimi nuk është bërë ose nuk po bëhet në pajtim me Programin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Pavarësisht nga sa më sipër, nëse auditimi i kërkuar nga Seksioni 5.02 nuk është përfunduar në mënyrë të pranueshme brenda dymbëdhjetë muajve nga data e raportimit financiar i parashikuar atje, Fondi pezullon të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga Llogaria e Huasë dhe e Grantit.

Seksioni 6.02. Anulimi. Fondi mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga llogaria e huasë dhe grantit, në pajtim me seksionin 12.02 të kushteve të përgjithshme, me zhvillimin e një prej rasteve të parashikuara atje ose nëse rishikimi afatmesëm ka rekomanduar që të ndërpritet programi.

Seksioni 6.03 Përsheptimi. Fondi mund të deklarojë shumën principale të pakthyer të huasë, së bashku me interesin e mbledhur dhe të papaguar mbi të, menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme në pajtim me seksionin 12.05 të kushteve të përgjithshme, me zhvillimin e një prej rasteve të parashikuara atje.

Seksioni 6.04. Mjete të tjera. Mjetet e Fondit të parashikuara në këtë nen nuk kufizojnë ose ndryshe pengojnë të drejtat ose mjetet e tjera në dispozicion të Fondit sipas kushteve të përgjithshme ose ndryshe, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në të drejtën e paraqitjes së deklarimeve të mashtrimit dhe korrupsionit tek autoritetet kombëtare.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Seksioni 7.01 Kushtet para hyrjes në fuqi. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në pajtim me nenin XIII të kushteve të përgjithshme (Hyrja në fuqi dhe përfundimi) duke përmbushur kushtet paraprake të mëposhtme:

a) Huamarrësi t'i ketë komunikuar Fondit me shkrim që Drejtori Ekzekutiv, zëvendës drejtori dhe kryellogaritari i Agjencisë së Drejtimit të Programit janë rregullisht në detyrë;

b) kjo Marrëveshje të jetë nënshkruar rregullisht, dhe nënshkrimi dhe kryerja e tij nga ana e Huamarrësit të jetë autorizuar dhe ratifikuar rregullisht nga të gjitha veprimet e nevojshme administrative qeveritare; dhe

c) Huamarrësi t'i ketë dhënë Fondit një mendim ligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë i Huamarrësit në lidhje me çështjet e parashikuara në seksionin 7.02 dhe në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Fondin.

Seksioni 7.02 Mendimi ligjor. Mendimi ligjor i kërkuar nga seksioni 7.01 trajton pozitivisht çështjet e mëposhtme:

a) kushti paraprak i përcaktuar në paragrafin (b) të seksionit 7.01 është përmbushur;

b) kjo Marrëveshje është ligjërisht detyruese për Huamarrësin në pajtim me kushtet e saj;
Seksioni 7.03 Afati për hyrjen në fuqi. Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi brenda 180 ditëve nga data e saj ose në një datë të mëvonshme që mund të përcaktohet nga Fondi, Fondi mund të përfundojë këtë Marrëveshje dhe dokumentet e tjera të huasë sipas parashikimit në seksionin 13.03 të kushteve të përgjithshme.

Neni 8 Të ndryshme

Seksioni 8.01. Përfaqësuesi. Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 15.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 8.02 Delegimi i autoritetit. a) Huamarrësi cakton Agjencinë e Drejtimit të Programit si agjentin e tij me autoritet të plotë për të ndërmarrë çdo veprim ose lidhur çdo marrëveshje me Fondin në emër të Huamarrësit në lidhje me :

i) tërheqjet nga llogaria e huasë dhe grantit dhe çdo detyrim të veçantë (Seksioni 2.02 këtu dhe programi 2 këtu; seksioni 4.03 i kushteve të përgjithshme);

ii) përdorimin e llogarive të programit (seksioni 3.03 këtu);

iii) prokurimin (programi 4 këtu) dhe

iv) të gjitha çështjet e tjera në lidhje me zbatimin e programit dhe raportimin përkatës (nenet III, IV dhe V këtu; programet 3 dhe 3A këtu; dhe nenet VII, VIII, IX dhe X të kushteve të përgjithshme).

b) Çdo veprim i ndërmarrë ose marrëveshje e përfunduar nga ky agjent në pajtim me autoritetin e dhënë do të jetë plotësisht detyrues për Huamarrësin dhe do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishte ndërmarrë ose përfunduar nga Huamarrësi.

c) Autoriteti i dhënë këtij agjenti mund të revokohet ose ndryshohet vetëm me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Seksioni 8.03 Komunikimet. Përveç kur parashikohet shprehimisht në dokumentet e huasë ose kërkohet nga Fondi, Huamarrësi ia drejton të gjitha komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje Fondit.

Seksioni 8.04. Adresat. Adresat e mëposhtme përcaktohen për njoftimet, kërkesat, raportet dhe komunikimet e tjera që jepen ose bëhen me shkrim sipas kësaj Marrëveshjeje:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr 2
Tirana Shqipëri
Faks. + (3554) 2228494

Për Fondin:
International Fund for Agricultural Development
Via Paolo di Dono, 44
00142 Rome
Italy
Faks. (3906) 504 3463

Seksioni 8.05 Gjuhët e komunikimeve. Të gjitha njoftimet, kërkesat, raportet, dokumentet dhe informacioni dhe komunikimet e tjera në lidhje me këtë Marrëveshje, huanë, grantin dhe programin (duke përfshirë raportet e kërkuara nga nenet IV dhe V) janë në gjuhën angleze. Kjo Marrëveshje është negociuar, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën angleze.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në Romë, Itali, në datën e shkruar më sipër.

Republika e Shqipërisë

Përfaqësuesi i Autorizuar

Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Ndërkombëtar

Presidenti

Programi 1

Përshkrimi i programit

1. Zona e programit. Programi mund të zbatohet në zonat e katër qarqeve veriorë të Shkodrës, Kukësit, Dibrës dhe Lezhës, ose ndonjë qarku tjetër të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit në territorin e Huamarrësit ("Zona e programit").

2. Grupi i synuar. Nga programi do të përfitojnë ekonomitë shtëpiake të varfra që jetojnë në zonën e programit.

3. Objektivi. Objektivi i programit është rritja e të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra dhe më të varfra në zonën e programit.

4. Qëllimi. Qëllimi i programit është reduktimi i varfërisë së vazhdueshme rurale nëpërmjet përmirësimit të mundësive të të varfërve ruralë për të marrë pjesë dhe punësuar në rrjetet rurale konkurruese dhe tregtare të furnizimit nëpërmjet zgjerimit të aksesit për në tregje, ekspertizës teknike dhe financës.

5. Përbërësit. Programi do të ketë tre komponentët e mëposhtëm: a) Zhvillimin e tregut rural; b) Infrastruktura e lidhjes me tregun; dhe c) Menaxhimin e programit.

a) Zhvillimi i tregut rural përbëhet nga katër nënkomponentët: i) Strategjia e informacionit dhe investimit; ii) Investimi strategjik në subjektet tregtare, duke përfshirë ngritjen e një instrumenti mbështetje për kreditin (CSF); iii) Ndërtimi i kapaciteteve për gratë; dhe iv) Shërbimet në ambientin rural.

b) Infrastruktura e lidhjes me tregun do të sigurojë grante kontribuuese konkurruese për investimet në infrastrukturën publike dhe menaxhimin e burimeve natyrore për të plotësuar investimet dhe aktivitetet e kryera në bazë të komponentit të zhvillimit të tregut rural.

c) Menaxhimi i programit. Kjo do të përbëhet nga mbështetja për Agjencinë e Drejtimit të Programit për zbatimin e aktiviteteve të programit.

Programi 2

Akordimi dhe tërheqja e shumave të huasë dhe grantit

1. Akordimi i shumave të huasë dhe grantit. Tabela më poshtë tregon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme për t'u financuar nga huaja dhe granti, akordimin e shumave të huasë dhe grantit për secilën kategori dhe përqindjet e shpenzimeve për zërat që duhet të financohen nga secila kategori:

Kategoria	Shuma e huasë së akorduar (shprehur në SDR)	Shuma e huasë e akorduar (shprehur në SDR)	% e Shpenzimeve të përshtatshme për t'u financuar
I. Punët civile	3 030 000		100% pa tatime dhe pa kontributin përfitues
II.Pajisje,mallra dhe automjete	120 000		100% pa tatime
III. Asistencë teknike dhe studime	330 000		100% pa tatime
a. Studime dhe sondazhe		30 000	
IV.Trajnime dhe seminare	50 000	130 000	100% pa tatime
V. Grante			
a Trajnim profesional	220 000		
b. Fermerë	980 000	100 000	100% pa tatime 100% pa tatime dhe pa kontributin përfitues
VI.Instrumenti i mbështetjes së kredisë	760 000		100% pa tatime dhe pa kontributin përfitues
VII. Kosto periodike	280 000		30% (PY1), 70% (PY2) 50% (PY3)

			30% (PY4) 20% (PY5) 0% (pas kësaj) të gjitha pa tatime
Totali i paakorduar	90 000 5 860 000	260 000	

2. Përkufizime të caktuara. Për qëllimet e këtij programi 2, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“Asistenca dhe studimet teknike” janë shpenzimet e përshtatshme për asistencën teknike, studimet dhe sondazhet ndërkombëtare dhe kombëtare.

“Instrument i mbështetjes së tregut” është një instrument garancie për të lehtësuar kërkesat për kolateral (deri në 40% të investimeve të propozuara) të institucioneve financiare, duke lehtësuar mundësimin e kreditit për subjektet sipërmarrëse të organizuara formalisht.

“Kosto periodike” janë shpenzimet e përshtatshme për pagat e menaxhimit të programit dhe honorarët, operimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe shpenzime të tjera operative.

3. Shumat minimale të tërheqjes. Tërheqjet nga llogaria e huasë dhe llogaria e grantit bëhen në shuma jo më të vogla se 20 000 USD ose ekuivalenti i tyre ose shuma të tjera që Fondi mund të caktojë herë pas here.

4. Pasqyrat e shpenzimeve. Tërheqjet nga llogaria e huasë dhe llogaria e grantit mund të bëhet kundrejt pasqyrave të certifikuara të shpenzimeve në lidhje me shpenzimet e përshtatshme në ato shuma që Fondi mund të caktojë herë pas here nëpërmjet njoftimit të Huamarrësit. Regjistrat që provojnë këto shpenzime nuk është e nevojshme t'i paraqiten Fondit, por mbahen nga Huamarrësi për inspektim nga përfaqësuesit e Fondit, në pajtim me seksionet 4.07 (Pasqyra e shpenzimeve) dhe 10.03 (vizita, inspektime dhe hetime) të kushteve të përgjithshme.

5. Kushtet paraprake të tërheqjes. Asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me shpenzimet sipas kategorisë VI të huasë për “Instrumentin e mbështetjes së kredisë”, sipas komponentit të zhvillimit të tregut rural derisa manuali CFS që parashikon modalitetet e përshkruara në programin 3, paragrafi B 2.3, të jetë pranuar nga Fondi.

Programi 3

Zbatimi i programit dhe marrëveshje shtesë

I. Zbatimi i programit

A. Organizimi dhe menaxhimi

1. Agjencia e Drejtimit të Programit

1.1. Caktimi. Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), e ngritur me vendim qeverie, në bazë të programit të mëparshëm të investimeve të IFAD-it, në cilësinë e saj si Agjenci e Drejtimit të Programit, ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e programit.

1.2. Përgjegjësitë. Agjencia e Drejtimit të Programit merr përgjegjësi të përgjithshme administrative dhe financiare për zbatimin e programit.

1.3. Menaxhimi. Menaxhimi i përgjithshëm i MADA-s i jepet bordit të saj ekzekutiv. Bordi ekzekutiv i MADA-s kryesohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë ose një kryetar tjetër që njoftohet nga Huamarrësi dhe aprovohet nga Fondi. Në nivel kombëtar, ministrinë, departamentet dhe agjencitë e rëndësishme përfaqësohen në nivel drejtori, për të përfshirë në radhë të parë Ministrinë e Financave MBUMK-un, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Ambientit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit dhe Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve. Në lidhje me problemet e gjinisë dhe rinisë, të paktën një përfaqësues i mundësive të barabarta do të emërohet në bord nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Interesat e sektorit publik në nivelet kyçe të pushtetit lokal do të përfaqësohen nga përfaqësues të zgjedhur të komunave dhe rajoneve të zonave malore të qarqeve të programit për zhvillim të qëndrueshëm në zonat malore rurale (SDRMA) dhe zona e programit me bazë rotacioni. Interesat e sektorit privat do të përfaqësohen nga Shoqata e Bankave, Dhoma(t) e Tregtisë dhe përfaqësuesi(t) e zgjedhur të shoqatave të prodhuesve/tregtare kryesore. Interesat e shoqërisë civile përfaqësohen nga personat e zgjedhur në nivel qarku të zonës malore Fora – përsëri me bazë rotacioni. Kryetari i bordit do të ketë përgjegjësinë për të ndryshuar përbërjen e përfaqësuesve të interesave të Huamarrësit mbi bazën e programit të secilës mbledhje të bordit. Në interes të përfaqësimit të plotë të partnerëve në qeverisjen e Agjencisë, përbërja e bordit do të rishikohet periodikisht në pajtim me miratimin e IFAD-it me synim sigurimin që, në një moment të caktuar, ai të pasqyrojë konfigurimin e përdoruesve të fundit individualë dhe organizativë të mallrave dhe shërbimeve të mbështetura nga programi.

1.4. Përbërja. Kërkesat për personelin e selisë së MADA-s dhe të zyrave të rrjetit të MADA-s përgjegjëse për zbatimin e programit rishikohen mbi një bazë të rregullt gjatë periudhës së zbatimit të programit për të konstatuar nevojat për personel duke pasur parasysh eksperiencën zbatuese. Çdo ndryshim në personalin e MADA-s do të bëhet në konsultim dhe me miratimin paraprak të Fondit.

B. Manualët e zbatimit të programit

2. Manualët e zbatimit të programit

2. Përgatitja. Si pjesë e përbërjes së programit, MADA do të përgatitë projektmanuale për: i) zbatimin e Instrumentit për Mbështetjen e Kreditit (Manuali CSF); ii) zbatimin e strategjisë së synuar të programit, dhe iii) zbatimin e nënkomponentit të shërbimeve për ambientin rural. Në lidhje me aspekte të tjera të zbatimit të programit, MADA miraton manualët e programit të zhvilluara sipas SDRMA, në lidhje me zbatimin e përgjithshëm, duke përfshirë prokurimin.

2.2. Aprovimi. MADA paraqet projektmanualet e zbatimit të programit te bordi ekzekutiv i MADA-s për aprovim sa më parë të jetë e mundur, por asnjëherë më vonë se 90 ditë pas datës së hyrjes në fuqi. Kur aprovohen si të tilla, MADA ia kalon projektmanualet e zbatimit të programit Fondit për komente dhe aprovim.

2.3. Miratimi. Bordi ekzekutiv i MADA-s miraton manualët e zbatimit të programit, kryesisht në formën e aprovuar nga fondi, dhe MADA i jep menjëherë Fondit kopje të tyre. Përveç Manualit CSF, nëse Fondi nuk komenton mbi projektmanualet e zbatimit të programit brenda 30 ditëve pas marrjes, ato konsiderohen të aprovuara. Manuali CSF konsiderohet të jetë i aprovuar nga Fondi dhe Huamarrësi me anë të një shkëmbimi formal komunikimi ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

C. Zbatimi i komponentëve të programit dhe instrumentet

Gjatë zbatimit të programit, Agjencia e Drejtimit të Programit bashkëpunon dhe bën bashkërendimin e ngushtë me institucionet dhe programet e zhvillimit si MBUMK-në, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, ADF-në, autoritetet e pushtetit lokal dhe rajonal dhe partnerë të tjerë përkatës.

3. Komponenti i zhvillimit të tregut rural

3.1. Instrumenti i mbështetjes së kreditit (CSF)

Ngrihet një instrument i mbështetjes së kreditit (CSF) brenda komponentit të zhvillimit të tregut rural, për të dhënë garanci huaje për ndërmarrjet për qëllime të përshtatshme. Struktura e CSF-së përfshin mekanizmat për verifikimin, mbajtjen e fondeve dhe administrimin, që parashikohet në Manualin CSF.

3.2. Shërbimet e ambientit rural

Zbatimi i nënkomponentit të shërbimeve të ambientit rural i besohet programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin brenda kuadrit të një programi të KB-së në Shqipëri, sipas një marrëveshjeje të pranueshme për Fondin.

II. Marrëveshje shtesë

1. Gjinia. Çështjet e gjinisë janë të standardizuara në të gjitha aktivitetet e programit në të gjithë periudhën e zbatimit të programit. Kjo përfshin:

a) mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi strukturat dhe proceset social-ekonomike të rajonit të zonave malore;

b) mundësi të barabarta gjinie për përfaqësimin në bordin ekzekutiv të MADA-s;

c) mundësi të barabarta gjinie për përfituesit e programit në lidhje me të gjithë komponentët e programit;

d) arritjen e qëllimeve të programit bazuar në gjini; dhe

e) sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të programit do të përfshijë, sipas mundësisë, të dhëna të ndara sipas gjinisë.

2. Menaxhimi i parazitëve. Si pjesë e praktikave të shëndosha për mirëmbajtjen e ambientit siç kërkohet nga seksioni 7.15 i kushteve të përgjithshme, palët në program kanë praktika të përshtatshme për menaxhimin e parazitëve sipas programit, që përfshin respektimin e parimeve të Kodit Ndërkombëtar të Sjelljes për Shpërndarjen dhe Përdorimin e Pesticideve të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO), që ndryshohet herë pas here dhe siguron që pesticidet e prokuruar sipas programit nuk do të përfshijnë asnjë formulë pesticidi që do të ishte klasifikuar si Tepër i Dëmshëm (Klasa Ia) ose Shumë i Dëmshëm (Klasa Ib), sipas klasifikimit të rekomanduar nga WHO-ja për pesticidet sipas dëmit dhe klasifikimi, të ndryshuar herë pas here.

3. Sigurimi i personelit të programit. Agjencia e Drejtimit të Programit siguron personelin kryesor të programit në pajtim me praktikën e zakonshme të brendshme.

4. Mashtrimi dhe korrupsioni. Huamarrësi sjell menjëherë në vëmendje të Fondit çdo deklarament ose

shqetësim, në lidhje me mashtrimin dhe/ose korrupsionin në lidhje me zbatimin e programit për të cilin ka njohuri ose ka marrë dijeni.

5. Qëndrueshmëria. Për të siguruar qëndrueshmërinë e komponentit të infrastrukturës së lidhjes me tregun, menjëherë sapo të jetë e mundur, por jo më vonë se 180 ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Agjencia e Drejtimit të Programit përgatit një program të detajuar për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës të pranueshëm për Fondin. Përveç kësaj, Agjencia e Drejtimit të Programit bashkëpunon vazhdimisht me institucionet përgjegjëse përkatëse si ADF-në për projektimin dhe ndërtimin e rrugëve rurale. Me qëllim që të zbatohet kjo punë, Agjencia e Drejtimit të Programit sqaron, arsyeton, zbaton dhe garanton masat e përshtatshme për operimin dhe menaxhimin e infrastrukturës rurale dhe siguron që investimet në lidhje me infrastrukturën e programit janë zbatuar në pajtim me legjislacionin kombëtar mbizotërues dhe të zbatueshëm.

Programi 4 Prokurimi

Pjesa A. Të përgjithshme

1. Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve të konsulencës financuar nga huaja dhe granti u nënshtrohet dispozitave të “Udhëzimeve për prokurimin” të IFAD-it të aprovuara nga bordi ekzekutiv në dhjetor 2004 (“Udhëzimeve për prokurimin”) ku këto udhëzime mund të ndryshohen herë pas here nga Fondi. Nëse një dispozitë e udhëzimeve të prokurimit është jo në pajtim me një dispozitë të këtij programi, zbatohet kjo e fundit.

2. Në masën që është e mundur, mallrat, punët dhe shërbimet e konsulencës përmblihen në paketa me madhësi të përshtatshme për oferta në mënyrë të tillë që lejon përdorimin optimal të ofertimit konkurrues.

3. Para fillimit të prokurimit dhe pas kësaj çdo vit, Huamarrësi i paraqet Fondit për aprovim, një planprokurimi të përshkruar në shtojcën 1, paragrafi 1 i udhëzimeve për prokurimin të IFAD-it. Plani i prokurimit përcakton, ndër të tjera, metodën e prokurimit për çdo kontratë që financohet dhe kufijtë minimalë dhe maksimalë dhe preferencat që duhet të përdoren për zbatimin e prokurimit sipas programit. Plani i prokurimit përcakton gjithashtu çdo kërkesë shtesë që mund të përcaktohet në udhëzimet e prokurimit të IFAD-it në lidhje me metoda të caktuara të prokurimit.

4. Prokurimi ndërmerret vetëm gjatë periudhës së zbatimit të programit.

5. Nuk ndërmerret asnjë prokurim, nëse ai realizon një pagesë për personat ose subjektet, ose një importim të mallrave të ndaluara me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Fondi informon Huamarrësin për këta persona, subjekte ose importe.

Pjesa B. Prokurimi i mallrave dhe punëve

6. a) Metodot që lejohen për prokurimin e mallrave dhe punëve janë si më poshtë:

- i) Ofertimi konkurrues kombëtar;
- ii) Blerjet ndërkombëtare ose kombëtare;
- iii) Kontraktimi i drejtpërdrejtë;
- iv) Prokurimi nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara;
- v) Prokurimi me pjesëmarrjen e komunitetit.

b) Prokurimi me pjesëmarrjen e komunitetit realizohet në pajtim me procedurat e pranueshme për Fondin dhe të përcaktuara në planin e prokurimit.

Pjesa C. Prokurimi i shërbimeve të konsulencës

7. Metodot që lejohen për prokurimin e shërbimeve të konsulencës janë si më poshtë:

- i) Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto;
- ii) Përzgjedhja e bazuar në cilësi;
- iii) Përzgjedhja me koston më të ulët;
- iv) Përzgjedhje e bërë bazuar në kualifikimet e konsulentëve;
- v) Përzgjedhje me burim të vetëm;
- vi) Përzgjedhje e konsulentëve individuale;
- vii) Praktikant tregtare.

Pjesa D. Kërkesat preferenciale

8. Në prokurimin e mallrave dhe punëve nga shumat e huasë dhe grantit në vendin e Huamarrësit mund të jepet një marzh preference sipas parashikimit të paragrafëve 55-59 (preferenca e brendshme) të udhëzimeve të prokurimit. Plani i prokurimit dhe të gjitha dokumentet e ofertimit tregojnë qartë preferencën e lejuar që jepet, mënyrën në të cilën zbatohet preferenca në krahasimin e ofertave dhe

informacioni i kërkuar për të vërtetuar përshtatshmërinë e një ofertuesi për këtë preferencë. Kombësia e një prodhuesi ose furnitori nuk do të jetë një kusht për një përshtatshmëri të tillë.

Pjesa E. Rishikimi i vendimeve të prokurimit

9. Dhënia e një kontrate për mallra të vlerësuar me kosto ekuivalente në 50 000 USD ose më shumë i nënshtrohet rishikimit paraprak nga Fondi. Kufiri minimal i sipërpërmendur mund të modifikohet herë pas here sipas njoftimit të IFAD-it drejtuar Huamarrësit.

10. Dhënia e një kontrate për mallra të vlerësuar me kosto ekuivalente në 50 000 USD ose më shumë i nënshtrohet rishikimit paraprak nga Fondi. Kufiri minimal i sipërpërmendur mund të modifikohet herë pas here sipas njoftimit të IFAD-it drejtuar Huamarrësit.

11. Dhënia e një kontrate për shërbimet e konsulencës të përmendur në paragrafin 7 më sipër të vlerësuar me kosto ekuivalente në 25 000 USD ose më shumë i nënshtrohet rishikimit paraprak të Fondit. Kufiri i sipërpërmendur mund të modifikohet herë pas here sipas njoftimit të IFAD-it drejtuar Huamarrësit.

12. Të gjitha dokumentet e ofertimit dhe kontratat për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të financuara nga huaja dhe granti përfshin një dispozitë që kërkon ofertuesit, furnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët të lejojnë IFAD-in të inspektojë llogaritë, regjistrat dhe dokumente të tjera të tyre, në lidhje me paraqitjen e ofertës dhe përmbushjen e kontratës dhe të auditohen nga auditues dhe hetues të emëruar nga IFAD-i. Kjo dispozitë kërkon që ofertuesit, furnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët të: i) mbajnë të gjithë dokumentet dhe regjistrat në lidhje me programin e financuar nga IFAD-i për tre vjet pas përmbushjes së punës së parashikuar në kontratën përkatëse, dhe ii) kërkojnë dhënien e çdo dokumenti të nevojshëm për hetimin e deklarimeve për mashtrim ose korrupsion dhe disponibilitetin e punonjësve ose agjentëve të ofertuesve, furnitorëve, kontraktorëve, nënkontraktorëve ose konsulentëve me njohurinë e tyre për programin e financuar nga IFAD-i për t'iu përgjigjur pyetjeve nga personeli i IFAD-it ose një auditues, hetuesi, agjent ose konsulent i caktuar rregullisht në lidhje me rishikimin ose auditimin e dokumentit. Nëse ofertuesi, furnitori, kontraktori, nënkontraktori ose konsulenti nuk përmbush kërkesën e IFAD-it, apo ndryshe pengon rishikimin e çështjes nga IFAD-i, IFAD-i, me iniciativë të vet, merr masat e duhura ndaj ofertuesit, furnitorit, kontraktorit, nënkontraktorit dhe konsulentit, duke përfshirë vendosjen e sanksioneve në pajtim me procedurat administrative të IFAD-it.

LIGJ

Nr.10 080, datë 23.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM (FSHZH) DHE KFW-SË, FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI PËR FURNIZIMIN ME UJË TË ZONAVE RURALE (FAZA 2)””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) dhe KFW-së, Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi për furnizimin me ujë të zonave rurale (Faza 2)””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6087, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE HUAJE DHE PROJEKTI

(datë 2008)

ndërmjet KfW, Frankfurt am Main ("KfW") dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Tiranë ("Huamarrësi") dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) ("Agjencia Zbatuese e Programit") për 1.5 milionë euro

Programi për Furnizimin me Ujë të Zonave Rurale (Faza 2)
(BMZ-Nr. 2008 65 998)

Mbi bazën e një marrëveshje që pritet të arrihet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar ("Marrëveshje qeveritare"), Huamarrësi, Agjencia Zbatuese e Programit dhe KfW në këtë mënyrë angazhohen në Marrëveshjen e mëposhtme të huasë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kredisë

1.1. KfW i ofron Huamarrësit një hua që nuk tejkalon shumën prej 1.5 milionë euro.

1.2. Huamarrësi ia kalon huanë e plotë Agjencisë Zbatuese të Programit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia Zbatuese e Programit përdor huanë vetëm për rehabilitimin dhe ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë të zonave rurale dhe, nëse nevojitet, për sistemet bazë të shkarkimit të ujërave të zeza dhe paguan shpenzimet korresponduese të këmbimit valutor. Agjencia Zbatuese e Programit dhe KfW përcaktojnë detajet e programit, pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja me anë të një marrëveshjeje të veçantë për të cilën duhet të bihet dakord nga ana e Huamarrësit të përfaqësuar nga Ministria e Financës.

1.3. Taksat dhe detyrimet e tjera publike do të shlyhen nga ana e Huamarrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Programit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga huaja.

Neni 2

Kalimi i huasë për Agjencinë Zbatuese të Programit

2.1. Huamarrësi ia kalon huanë Agjencisë Zbatuese të Programit si një grant jo të ripagueshëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë të kalimit të fondeve.

2.2. Para disbursimit të parë të huasë, Huamarrësi i dërgon KfW-së një kopje të marrëveshjes së kalimit të fondeve të specifikuar në nenin 2.1.

2.3. Kalimi i huasë nuk përbën asnjë përgjegjësi të Agjencisë Zbatuese të Programit kundrejt KfW-së për detyrimet për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1. KfW do ta disbursojë huanë në përputhje me progresin e programit dhe në bazë të kërkesës së Agjencisë Zbatuese të Programit. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia Zbatuese e Programit dhe KfW bien dakord mbi procedurën e disbursimit, në veçanti mbi të dhënat që provojnë se shumatat e kërkuara të huasë janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2. KfW gëzon të drejtën t'i refuzojë disbursimet mbas 31 dhjetorit 2016.

Neni 4

Komisioni i angazhimit, interesi dhe shlyerja

4.1. Huamarrësi paguan një komision angazhimi prej 1/4 % p.a. mbi shumatat e disbursuara të huasë. Komisioni financiar i angazhimit llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj mbas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe përfundon në datën në të cilën disbursimet janë debituar.

4.2. Huamarrësi paguan interes mbi huanë në masën 2% p.a. Interesi shlyhet nga data në të cilat debitohej disbursimet deri në datat në të cilat pagesat kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në

nenin 4.9.

4.3. Huamarrësi paguan komisionin e angazhimit, interesin dhe çdo interes për vonesat në vijim të nenit 4.5 dy herë në vit më 30 qershor dhe 30 dhjetor në mes të vitit dhe në përfundim të tij. Komisioni i parë i angazhimit përkon së bashku me pagesën e interesit të parë.

4.4. Huamarrësi shlyen huanë, si më poshtë:

Kësti	Data		Shuma	
1.	qershor 30	2019	37.000,00	
2.	dhjetor 30	2019	37.000,00	euro
3.	qershor 30	2020	37.000,00	euro
4.	dhjetor 30	2020	37.000,00	euro
5.	qershor 30	2021	37.000,00	euro
6.	dhjetor 30	2021	37.000,00	euro
7.	qershor 30	2022	37.000,00	euro
8.	dhjetor 30	2022	37.000,00	euro
9.	qershor 30	2023	37.000,00	euro
10.	dhjetor 30	2023	37.000,00	euro
11.	qershor 30	2024	37.000,00	euro
12.	dhjetor 30	2024	37.000,00	euro
13.	qershor 30	2025	37.000,00	euro
14.	dhjetor 30	2025	37.000,00	euro
15.	qershor 30	2026	37.000,00	euro
16.	dhjetor 30	2026	37.000,00	euro
17.	qershor 30	2027	37.000,00	euro
18.	dhjetor 30	2027	37.000,00	euro
19.	qershor 30	2028	37.000,00	euro
20.	dhjetor 30	2028	37.000,00	euro
21.	qershor 30	2029	38.000,00	euro
22.	dhjetor 30	2029	38.000,00	euro
23.	qershor 30	2030	38.000,00	euro
24.	dhjetor 30	2030	38.000,00	euro
25.	qershor 30	2031	38.000,00	euro
26.	dhjetor 30	2031	38.000,00	euro
27.	qershor 30	2032	38.000,00	euro
28.	dhjetor 30	2032	38.000,00	euro
29.	qershor 30	2033	38.000,00	euro
30.	dhjetor 30	2033	38.000,00	euro
31.	qershor 30	2034	38.000,00	euro
32.	dhjetor 30	2034	38.000,00	euro
33.	qershor 30	2035	38.000,00	euro
34.	dhjetor 30	2035	38.000,00	euro
35.	qershor 30	2036	38.000,00	euro
36.	dhjetor 30	2036	38.000,00	euro
37.	qershor 30	2037	38.000,00	euro
38.	dhjetor 30	2037	38.000,00	euro
39.	qershor 30	2038	38.000,00	euro
40.	dhjetor 30	2038	38.000,00	euro

4.5. Në rast se kështet e shlyerjes nuk vihen në dispozicion të KfW-së brenda afatit, KfW mund të rrisë normën e interesit për vonesat me normën bazë plus 3% p.a. për periudhën që fillon në datën e caktuar dhe që mbaron në datën në të cilën pagesat në fjalë kreditohen në llogarinë e KfW të specifikuar në nenin 4.9. “Norma bazë” është në normën e interesit të publikuar nga Deutsche Bundesbank si normë bazë e aplikueshme në datën përkatëse të caktuar. Në rast vonesash në pagesa, KfW mund të kërkojë zhdëmtim. Zhdëmtimet në fjalë nuk e kalojnë shumën që do të krijohej në rast se do të aplikohet interes mbi interesin e pagesave të prapambetura mbi bazën e interesit ekzistues në datën e caktuar plus 3% p.a.

4.6. Komisioni i angazhimit, interesi dhe çdo detyrim mbi pagesat e prapambetura në vijim të nenit

4.5 llogaritet mbi bazën e vitit me 360 ditë dhe muajt me 30 ditë.

4.7. Shumat e huasë të padisbursuara ose të shlyera parakohe kreditohen në përpjesëtim të njëjtë kundrejt të gjitha kësteve të papaguara për t'u shlyer, përveçse kur KfW me iniciativën e saj vendos një mënyrë ndryshe kompensimi në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave me sasi më të vogël.

4.8. KfW gëzon të drejtën të kreditojë, sipas iniciativës së saj, pagesat e marra para afatit të pagesave në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera të huave të arritura ndërmjet KfW dhe Huamarrësit.

4.9. Huamarrësi dërgon të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW nr. 31.256.0801 në KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S.W.I.F.T: KFWIDEFF. Nuk pranohet asnjë kompensim për kundër pretendime kundrejt pagesave të tilla.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e parakohshme

5.1. Huamarrësi mund në çdo kohë

a) në varësi të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 8, të anulojë çdo shumë të huasë të padisbursuar ende, dhe

b) të paguajë pjesërisht ose të gjithë huanë para maturimit të saj.

5.2. KfW mund të mos pezullojë disbursimet, përveçse kur

a) Huamarrësi ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj KfW-së për të realizuar pagesat në kohën e duhur;

b) Shkelen detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose në bazë të marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje;

c) Agjencia Zbatuese e Programit nuk është në gjendje të provojë se shumat e huasë janë përdorur për qëllimin e caktuar, ose kur

d) Hasen rrethana të jashtëzakonshme, të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht implementimin, operimin ose qëllimin e programit ose realizimin e detyrimeve të pagesave të pranuar nga ana e Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

5.3. Në rast se një nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b) ose c), haset ose nuk eliminohet brenda një periudhe të përcaktuar nga ana e KfW-së, e cila, megjithatë duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW mund

a) në rastet e specifikuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b), të kërkojë pagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit të grumbulluar dhe të gjitha detyrimet e tjera të rastit;

b) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c), të kërkojë pagesën e menjëhershme të shumave në fjalë të huasë pasi Agjencia e Zbatimit të Programit nuk është në gjendje të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6

Shpenzimet dhe detyrimet publike

6.1. Huamarrësi realizon të gjitha pagesat për efekt të kësaj Marrëveshjeje, pa zbritur taksat, detyrimet e tjera publike ose shpenzime të tjera dhe paguan shpenzimet e transferimit dhe konvertimit, të cilat rrjedhin si pasojë e disbursimit të huasë.

6.2. Huamarrësi mbart të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që rrjedhin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në përputhje me arritjen dhe zbatimin të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje dhe përfaqësimi

7.1. Në momentin e duhur para lëvrimit të parë, Huamarrësi i siguron KfW-së të dhëna të kënaqshme, ku provohet se ai/Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat në bazë të ligjeve të tij kushtetuese dhe ligjeve të tjera për pranimin e vlefshëm të të gjitha detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.2. Ministri i Financave dhe persona të tillë të përcaktuar prej tij/saj para KfW-së dhe të autorizuar me anë të nënshkrimeve mostër të vërtetuara prej tij/saj, përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar për Zhvillim dhe persona të tjerë të përcaktuar prej

tij/saj para KfW-së dhe të autorizuar me anë të nënshkrimeve mostër të vërtetuara prej tij/saj, përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese të Programit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Autoritetet e përfaqësimit nuk përfundojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të anulimit të qartë prej përfaqësuesve të autorizuar.

7.3. Amendamentet ose shtojcat kundrejt kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe formulim i paraqitur nga ana e palëve kontraktuese në bazë të kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Njoftimet dhe formulimet e tilla quhen të realizuara pasi të kenë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese korresponduese ose në çdo adresë tjetër të palës kontraktuese korresponduese të njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW:

KfW
Department L3A4
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 4
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Fax: +355-4-228494

Për Agjencinë Zbatuese të Programit:

Albanian Development Fund
Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Fax: +355-4-234885

7.4. Ndryshimet ndaj kësaj Marrëveshjeje, të cilat ndikojnë vetëm mbi raportin ligjor ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë Zbatuese të Programit.

Neni 8 Programi

8.1. Agjencia Zbatuese e Programit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe ruan programin konform praktikave të shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Programit dhe KfW-së;

b) u akordon konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të programit, dhe kompanive të kualifikuara zbatimin e programit;

c) akordon kontratat për pajisje dhe shërbime që financohen nga huaja, në përputhje me marrëveshjen e veçantë që do të lidhet me KfW-në;

d) ruan ose realizon ruajtjen e regjistrave dhe të dhënave të cilat tregojnë qartë të gjitha shpenzimet e pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për programin dhe identifikojnë qartë pajisjet dhe shërbimet e financuara nga kjo hua;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së që, në çdo kohë, të inspektojnë regjistrat dhe të dhënat në fjalë, si dhe çdo e të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin e programit dhe u mundëson të vizitojnë programin dhe instalimet që lidhen me të;

f) i siguron KfW-së çdo dhe të gjitha të dhënat dhe raportet mbi programin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së; dhe

g) pa vonesë i përcjell KfW-së çdo pyetje të marrë prej Huamarrësit, prej OECD ose anëtarëve të saj në bazë të të ashtuquajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive të palidhura ODA" mbas akordimit të kontratave për pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe koordinon përgjigjet e pyetjeve të tilla me KfW.

8.2. Agjencia Zbatuese e Programit dhe KfW do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të programit dhe, në bazë të kërkesës, i sigurojnë KfW-së të dhëna që provojnë se shpenzimet e papaguara nga huaja janë mbuluar; dhe

b) me pëlqimin e tyre informojnë menjëherë KfW-në mbi çdo ose të gjitha rrethanat të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit.

8.4. Huamarrësi asiston Agjencinë Zbatuese të Programit konform praktikave të shëndosha financiare dhe inxhinierike në zbatimin e programit dhe në realizimin e detyrimeve të agjencisë zbatuese të projektit në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, i akordon kësaj të fundit çdo dhe të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e programit.

8.5. Për transportimin e pajisjeve që do të financohen nga huaja, zbatohen dispozitat e marrëveshjes qeveritare të njohura për Huamarrësin.

Neni 9

Dispozita të përgjithshme

9.1. Huamarrësi dhe Agjencia Zbatuese e Programit sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e programit, akordimin e çdo kontrate për pajisje dhe shërbime dhe me disbursimet në bazë të kërkesës, që financohen nga shumata e huasë nuk pretendojnë, pranojnë, diskutojnë, akordojnë, premtojnë, ose përfitojnë një premtim për pagesë të paligjshme ose avantazhe të tjera lidhur me këto detyra.

9.2. KfW gëzon të drejtën ta pajisë Republikën Federale të Gjermanisë me të dhëna lidhur me lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje. Si KfW ashtu edhe Republika Federale e Gjermanisë gëzojnë të drejtën të përcjellin të dhëna mbi huanë dhe programin, përfshirë akordimin e kontratave për pajisje dhe shërbime që do të financohen nga huaja organizatave ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht lidhur me aspektet e shërbimit debitor dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave lidhur me akordimin e kontratave për pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja. E drejta e lartpërmendur për t'u përcjellë të dhëna organizatave ndërkombëtare gjithashtu përfshin të drejtën për t'iu kaluar të dhëna të tilla anëtarëve të organizatave në fjalë.

9.3. Në rast se një nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera në këtë mënyrë mbeten të paprekura. Çdo hapësirë e krijuar për pasojë plotësohet me një dispozitë që është në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.4. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Programit mund të mos ngrenë ose transferojnë, zotohen ose kërkojnë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.5. Të gjitha pretendimet e KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje, skadojnë mbas pesë vitesh nga fundi i vitit në të cilin ndodh një pretendim i tillë dhe në të cilin KfW është e vetëdijshme për rrethanat që përbëjnë pretendimin në fjalë ose mund të ishte e vetëdijshme pa krijuar një neglizhencë të madhe.

9.6. Kjo Marrëveshje drejtohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i realizimit mbetet Frankfurt am Main.

9.7. Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin ose lidhen me Marrëveshjen aktuale zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, do të zbatohet:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitër të arbitrazhit, të cilët do të emërohen dhe veprojnë në përputhje me rregulloret e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (DHNT) të aplikueshme herë mbas here.

b) Seancat e arbitrazhit do të zhvillohen në Frankfurt am Main. Seancat do të zhvillohen në gjuhën angleze.

9.8. Kjo hua dhe marrëveshje projekti nuk do të hyjë në fuqi derisa marrëveshja qeveritare në të cilën ajo bazohet të ketë hyrë në fuqi.

Hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,

Në këtë ditë..... 2008

Tirana,

Në këtë ditë..... 2008

KfW

Ministria e Financave

Fondi Shqiptar për Zhvillim

LIGJ
Nr.10 081, datë 23.2.2009

PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

Neni 2
Objekti dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj përcakton:
- a) parimet për përcaktimin e veprimtarive, të veprimeve dhe tipave të të mirave publike, ushtrimi, kryerja dhe përdorimi i të cilave u nënshtrohet licencimit, autorizimit apo lejimit;
 - b) parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve dhe parimet për shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;
 - c) organizimin dhe përmbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Licencave dhe Lejeve;
 - ç) procedurat për trajtimin e disa licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore;
 - d) rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Licencimit.
2. Ligji është i zbatueshëm për:
- a) të gjitha licencat e autorizimet, për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake;
 - b) të gjitha lejet për përdorimin e të mirave publike, për qëllime të veprimtarive të sipërpërmendura, përveç përdorimit të të mirave publike për qëllime vetjake.

Neni 3
Përkufizim i termave

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
- a) “Ministria” është ministria, që mbulon çështjet e ekonomisë.
 - b) “Ministër” është ministri që mbulon çështjet e ekonomisë.
 - c) “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjisllacionit në fuqi, për një licencë/autorizim/leje të caktuar.
 - ç) “Institucion qendror” është Këshilli i Ministrave, çdo ministri dhe çdo institucion publik në varësi të tyre.

d) “Institucion i pavarur” është çdo institucion i pavarur, sipas Kushtetutës apo i krijuar me ligj dhe çdo organ i njësisve të pushtetit vendor, që ka në kompetencë dhënien e një licence, autorizimi apo lejeje.

dh) “Institucion tjetër” është çdo institucion qendror ose i pavarur, që ka kompetenca të caktuara për verifikimin e përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe çdo subjekt privat, të cilit i është dhënë, sipas ligjit, një kompetencë e tillë.

e) “Veprimtari” është çdo veprimtari e natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që nuk është e natyrës vetjake.

ë) “Veprim” është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, që nuk është i natyrës vetjake, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licencohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mire publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.

f) “E mirë publike” është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi, në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuenca dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi.

g) “Përdorim i së mirës publike” është e drejta për të administruar një të mirë publike, për të gëzuar frytet e saj, për t’ia ndryshuar karakteristikat fizike, për ta përdorur si lëndë, për të përdorur hapësirën për ndërtime, për të shkarkuar mbetje në mjedis, si dhe forma të tjera përdorimi të këtyre natyrave, për qëllimet apo nevojat e një veprimtarie, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

gj) “Licencë” është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

h) “Autorizim” është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

i) “Leje” është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të përdorë një të mirë publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

j) “Titullar i licencës/autorizimit/lejes” është personi juridik apo personi fizik, që ka marrë një licencë, autorizim apo leje.

k) “Kushte të licencimit/autorizimit/lejimit” janë ato kushte, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave nga titullari i licencës/autorizimit/lejes është e detyrueshme.

l) “Kritere të licencimit/autorizimit/lejimit” është ajo pjesë e kushteve, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës/autorizimit/lejes.

ll) “Detyrime të licencimit/autorizimit/lejimit” është ajo pjesë e kushteve, që kërkohen të përmbushen përgjatë kryerjes së veprimtarisë, të veprimit apo përdorimit të së mirës publike.

m) “Dokument provues” është akti shkresor i një institucioni publik, privat apo akti i përgatitur nga vetë kërkuesi e që provon përmbushjen e një kushti licencimi/autorizimi/lejeje.

n) “Dokument tjetër shoqërues” është një dokument i detyrueshëm për t’u paraqitur, për pajisjen me licencë/autorizim/leje e që nuk është dokument provues.

nj) “Dokumente shoqëruese” janë dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese e të marra së bashku.

o) “Kërkues” është personi fizik apo juridik, që kërkon pajisjen me licencë, autorizim apo leje.

p) “QKL” është Qendra Kombëtare e Licencimit.

q) “Regjistër” është Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve.

2. Në kuptim të këtij ligji, vlerësohen licencë, autorizim apo leje të gjithë termat e përdorur në legjislacionin tjetër në fuqi, të tillë, si: certifikatë, pëlqim, regjistrim, njoftim, notifikim, kontratë apo edhe vetë termat licencë, leje, autorizim, si dhe çdo term tjetër, kur, sipas qëllimit në legjislacionin përkatës, kuptimi i atij termi përkon, përkatësisht, me kuptimin e termave licencë, autorizim ose leje, të përcaktuar në këtë ligj.

KREU II

PARIMET E NISMAVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUSHËN E LICENCIMIT, AUTORIZIMIT DHE LEJEVE

Neni 4

Nismat në fushën e licencave/autorizimeve/lejeve

Çdo nismë e një projektligji apo akti nënligjor, që propozon parashikimin në legjislacionin shqiptar të:

- a) një licence për ushtrimin e një veprimtarie;
 - b) një lejeje për përdorimin e një të mire publike;
 - c) një autorizimi për kryerjen e një veprimi;
 - ç) kushteve të licencimit, autorizimit apo lejimit;
 - d) dokumenteve shoqëruese për pajisjen me një licencë, autorizim apo leje;
 - dh) procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, për pajisjen me një licencë, autorizim apo leje;
 - e) afateve të vlefshmërisë së një licence/autorizimi/lejeje;
 - ë) organit kompetent për inspektimin apo revokimin e licencës/autorizimit/lejes dhe/ose shkaqeve e procedurave të pezullimit dhe/ose revokimit të tyre;
- duhet të jetë për secilën nga këto çështjet e sipërpërmendura, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenet 5 deri në 12 të këtij kreu.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

1. Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Përdorimi i të mirave publike në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet, si rregull, vetëm nga subjektet, që janë lejuar për këtë, në bazë të një lejeje, sipas legjislacionit në fuqi, përveçse kur e mira publike, për shkak të natyrës dhe karakteristikave të saj, është për përdorim të lirë të publikut të gjerë apo parashikohet ndryshe me ligj.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.

Neni 6

Parimet për përcaktimin e veprimtarive që u nënshtrohen licencimit dhe autorizimit

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kritereve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.

Neni 7

Parimet për përcaktimin e veprimtarive që i nënshtrohen lejes

Përdorimi i një të mire publike, nëpërmjet një lejeje, bëhet vetëm nëse plotësohet, të paktën, njëra nga këto rrethana:

a) kur nëpërmjet procesit të dhënies së lejes, synohet marrja e kundërvleftës më të mirë në interes publik;

b) përdorimi i lirë i së mirës publike nga subjekte, që nuk zotërojnë njohuritë, teknologjitë apo garanci të tjera të nevojshme, shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj ose një shfrytëzim të papërshtatshëm;

c) kur e mira publike, për shkak të kufizimit të saj në sasi, shtrirje, hapësirë apo kohë, ose për shkak të rrethanave të tjera, të arsyeshme, nuk lejon, përveçse një numër të kufizuar përdoruesish apo përdorim të kufizuar, ose kur përdorimi i lirë i së mirës publike nga një numër i pakufizuar subjektsh apo pa kufizim në sasi dhe/ose shtrirje në hapësirë dhe/ose kohë shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj apo një shfrytëzim të papërshtatshëm.

Neni 8

Parimet për përcaktimin e kushteve të licencimit/autorizimit

1. Kushtet e licencimit apo autorizimit bazohen në parimet e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative.

2. Kushtet e licencimit apo autorizimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publikë që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

3. Kushtet e licencimit apo autorizimit përcaktohen e shprehen, bazuar në tregues objektivë, të matshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

4. Çdo kërkues, që plotëson kriteret e licencimit apo autorizimit, fiton të drejtën që ta ushtrojë atë veprimtari apo, përkatësisht, ta kryejë atë veprim.

5. Përfundimisht, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, sipas nenit 6 të këtij ligji, mund të përcaktohet një kufizim sasior i veprimtarive apo veprimeve, nëpërmjet kufizimit të numrit të licencave për atë veprimtari, apo autorizimeve për atë veprim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, nisma ligjore përcakton që licenca apo autorizimi i jepet një numri të kufizuar kërkuesish që, përveçse plotësojnë kriteret bazë të licencimit apo, përkatësisht, autorizimit, arrijnë, gjithashtu, vlerësimin më të mirë, krahasuar me kërkuesit e tjerë, në përputhje me disa kritere dhe procedura konkurruese, të paravendosura, transparente e të drejta.

Neni 9

Parimet për përcaktimin e kushteve të lejimit

1. Kushtet e lejimit, për çdo lloj të mire publike, bazohen në parimet e ruajtjes, të shtimit dhe mirëpërdorimit të së mirës publike, maksimizimit të përfitimit publik, si dhe të proporcionalitetit, deburokratizimit dhe mosdiskriminimit të padrejtë.

2. Kushtet e lejimit përcaktohen e shprehen bazuar, sa më shumë të jetë e mundur, në tregues objektivë, të matshëm, të krahasueshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

3. Kriteret e lejimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publikë, që garantojnë dhe mund të jenë kualifikuese dhe/ose konkurruese.

4. Kriteret kualifikuese shërbejnë për të përzgjedhur kërkuesit, që përmbushin kërkesat minimale dhe/ose të domosdoshme për përdorimin e së mirës publike. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve kualifikuese mund të jetë pjesë e një procesi lejimi ose një procesi paraprak licencimi. Në këtë rast, licencimi është kusht paraprak, i domosdoshëm për lejimin.

5. Kriteret konkurruese shërbejnë për të përcaktuar kërkuesin, që ofron përdorimin më të përshtatshëm dhe/ose kundërvleftën më të mirë, krahasuar me kërkuesit e tjerë, që kanë përmbushur kriteret kualifikuese. Konkurrimi bazohet në procedura e kritere të paravendosura, transparente e të

drejta.

Neni 10

Parimet për përcaktimin e procedurave të licencimit, autorizimit dhe lejimit

1. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve të licencimit, të autorizimit apo dhënies së lejes bazohet, sipas rastit, në: vetëdeklarimet e kërkuarit, dokumentet e lëshuara nga organe të tjera publike apo institucione të tjera private, kryerjen e vlerësimeve, inspektimet paraprake apo organizimin e testeve, të provimeve, garave, intervistave, dëgjimit ose të metodave të tjera të përshtatshme.

2. Procedurat për trajtimin e kërkesave për licenca, autorizime e leje duhet të jenë të qarta, të thjeshta, transparente dhe të mbështeten, sa më shumë të jetë e mundur, në:

- a) miratimin e heshtur;
- b) mjetet elektronike të informimit e të komunikimit, përfshirë aplikimin on line;
- c) modelin e qendrës me një ndalesë;
- ç) shkëmbimin e integruar të informacionit e të dokumentacionit ndërmjet organeve publike;
- d) pagesën për shërbimin administrativ të licencimit/autorizimit/lejes, kur parashikohet, e cila duhet të mbulojë vetëm koston dokumentare;
- dh) taksat dhe/ose tarifat për dhënien e licencave/autorizimeve/lejeve, kur parashikohen, duhet të jenë të arsyeshme e në funksion të arritjes së qëllimeve të këtyre instrumenteve.

Këto procedura duhet të kryhen në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Kur dokumentet që provojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit, autorizimit apo lejes ose të dhënat e deklaruara nga kërkuari janë në regjistrat elektronikë të institucioneve publike dhe janë të aksesueshme nga organi publik, ku bëhet kërkesa, kërkuari nuk detyrohet t'i paraqesë ato dokumente, me kushtin që ai të tregojë qartë në kërkesë-referencën e këtyre të dhënave në regjistrin përkatës.

4. Organet publike, që kanë kompetencë në procesin e dhënies së licencave, autorizimeve apo lejeve, në çdo rast, sigurojnë, nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare të internetit dhe mjeteve të tjera të përshtatshme, informimin e plotë të të interesuarve e të publikut për kuadrin ligjor, kriteret, procedurat, afatet, format e aplikimit dhe dokumentet shoqëruese të kërkuara, si dhe ofrojnë shërbime këshillimi për kërkuarin.

Neni 11

Parimet për përcaktimin e afateve të vlefshmërisë së licencës, autorizimit dhe lejes

1. Afati i parashikuar i vlefshmërisë së licencës/autorizimit/lejes duhet të jetë i përshtatshëm për arritjen e qëllimit.

2. Vlefshmëria e një licence duhet të jetë, si rregull, pa afat e, në rast të kundërt, afati të jetë aq më i gjatë, sa ka arsye të besohet se kushtet e licencimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.

3. Afati i vlefshmërisë së një lejeje duhet të jetë aq i gjatë, sa ka arsye të besohet se kushtet e lejimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.

4. Afati i vlefshmërisë së një autorizimi duhet të jetë aq i gjatë, sa të lejojë kryerjen normale të veprimit të autorizuar.

Neni 12

Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për revokimin e licencës/autorizimit/lejes

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

2. Konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste.

3. Përpara marrjes së vendimit të revokimit, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për

ripërmbyshjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

4. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

5. Licenca/autorizimi/leja, si rregull, revokohen:

- a) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbyshjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;
- b) në rast të moszbatimit të urdhërimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
- c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik, që garantohej nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.

Neni 13

Procedurat për nismat ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit, të autorizimit dhe lejeve

1. Çdo nismë normative në fushën e licencimit/autorizimit/lejimit, sipas nenit 4 të këtij ligji, shpallet publikisht në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në faqen zyrtare të internetit dhe me mjete të tjera të përshtatshme, të paktën 30 ditë para shqyrtimit të tij përfundimtar nga organi miratues. Në rastin e projektligjeve, për të cilat të drejtën e nismës e ushtron Këshilli i Ministrave, shpallja bëhet 30 ditë përpara paraqitjes për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës dhe ministri.

2. Shpallja, sipas pikës 1 të këtij neni, përmban, të paktën, raportin e vlerësimit të pasojave, sipas pikës 5 të këtij neni dhe projekt-aktin përkatës.

3. Gjatë kësaj kohe, çdo organ tjetër publik, çdo palë e interesuar apo publiku mund të dërgojnë vërejtje. Brenda kësaj periudhe, organi nismëtar organizon, të paktën, një dëgjim publik, për t'u njohur me sugjerimet e organeve të tjera apo të palëve të interesuara.

4. Çdo nismë, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqërohet, në procesin e shqyrtimit dhe të miratimit, përveç sa parashikohet nga legjislacioni në fuqi, edhe me këto dokumente:

- a) mendimin këshillimor të Qendrës Kombëtare të Licencimit;
- b) raportin e vlerësimit të pasojave.

5. Raporti i vlerësimit të pasojave përmban informacion të hollësishëm për objektivat dhe qëllimet e nismës, opsionet për arritjen e objektivave, krahasimin e opsioneve të ndryshme, pasojat e pritshme të opsionit të propozuar, përputhjen e opsionit të propozuar me secilin nga parimet e këtij ligji, një përmbledhje të këshillimeve publike të zhvilluara dhe vërejtjet e propozimet e bëra gjatë këtyre këshillimeve.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rregulla të hollësishme për procedurën e vlerësimit të pasojave dhe përmbajtjen e raportit përkatës.

KREU III

REGJISTRI KOMBËTAR I LICENCAVE DHE LEJEVE

Neni 14

Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve

1. Çdo licencë/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

3. Regjistri organizohet në tri pjesë:

- a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve;
- b) regjistri informativ, sipas kategorive të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- c) regjistri aplikativ i licencave dhe lejeve.

4. Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore përmban të gjitha projekt-aktet e nismave ligjore

dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKL-së.

5. Regjistri informativ përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

a) kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
b) kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;

c) procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;

ç) udhëzimet për bërjen e kërkesave.

6. Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

a) çdo kërkesë për pajisjen me licencë/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;

b) çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;

c) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;

ç) çdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kriterëve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/lejes apo pezullimin e licencës/lejes;

d) çdo vendim për revokimin e një licence/lejeje;

dh) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të kësaj pike;

e) çdo licencë/leje të dhënë e të vlefshme;

ë) vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;

f) çdo vendim tjetër për një licencë/leje të caktuar.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës, përcakton kategoritë e autorizimeve, pjesë e regjistrit aplikativ dhe një apo disa nga të dhënat e parashikuara në pikën 6 të këtij neni, që përfshihen në regjistrin aplikativ për to.

8. Regjistri Kombëtar mbahet nga QKL-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKL-ja, çdo institucion i pavarur dhe çdo institucion qendror, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrit Kombëtar për pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

9. Organi nismëtar i nismës ligjore, me përjashtim kur është institucioni i përmendur në pikën 8 të këtij neni, dërgon projekt-aktin dhe raportin e vlerësimit të pasojave për publikim nga QKL-ja.

10. Çdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin Kombëtar, për të publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës për licencim/autorizim/leje.

11. Çdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistër, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

12. Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave “dh” dhe “ë” të pikës 6 të këtij neni, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administron regjistrin për licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete të përshtatshme.

13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Ministri miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e regjistrit, krijimin, administrimin, formatimin, përmbajtjen, lidhjen në rrjet me institucionet e përfshira në procesin e licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe procedurat e sigurisë së tij.

KREU IV

KOMPETENCAT PËR TRAJTIMIN E LICENCAVE/AUTORIZIMEVE/LEJEVE TE INSTITUCIONEVE QENDRORE

Neni 15

Kompetenca për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve

1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive, në kompetencë të institucioneve qendrore, parashikohen në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Parashikimi i kategorive të tjera të licencave/lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, nga ato të paparashikuara në shtojcë është i mundur vetëm nëpërmjet ndryshimit të kësaj shtojce.
3. Kërkesat për licencat e lejet e parashikuara në shtojcë apo nënkategoritë e tyre trajtohen:
 - a) si rregull, nga apo nëpërmjet QKL-së;
 - b) në raste të veçanta, nga organet e përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi, pa përfshirjen e QKL-së.
4. Autorizimet, në kompetencë të institucioneve qendrore, përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe kërkesat për to trajtohen:
 - a) si rregull, drejtpërdrejt nga institucionet kompetente, pa përfshirjen e QKL-së;
 - b) në raste të veçanta, nga apo nëpërmjet QKL-së.
5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, përcakton:
 - a) nënkategori të licencave e të lejeve, të përcaktuara në shtojcë;
 - b) licencat, autorizimet dhe lejet apo nënkategoritë e tyre, kërkesat për të cilat trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, sipas kreut V të këtij ligji.

KREU V

PROCEDURAT E LICENCIMIT/AUTORIZIMIT/LEJIMIT NGA APO NPËRMJET QKL-SË

SEKSIONI 1

NDARJA NË GRUPE

Neni 16

Grupet e licencave/autorizimeve/lejeve

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton ndarjen e licencave, të autorizimeve dhe lejeve dhe/ose nënkategorive të tyre, që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, në një nga tre grupet e përcaktuara në pikat 2, 3 e 4 të këtij neni.
2. Grupi i parë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bazohet vetëm në vetëdeklarimet e kërkuarit.
3. Grupi i dytë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, përveçse në vetëdeklarimet e kërkuarit, bazohet, për të paktën njërin nga kushtet, edhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.
4. Grupi i tretë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat, përveç sa parashikohet në pikat 2 e 3 të këtij neni, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, për të paktën njërin prej tyre, bazohet edhe në kryerjen e një procesi inspektimi, testimi, gare, interviste, dëgjimi apo metode tjetër vlerësimi.

SEKSIONI 2

KËRKESA, SHQYRTIMI DHE VENDIMARRJA

Neni 17

Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.
2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.
3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;
 - b) llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;
 - c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;

ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës;

d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;

dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim;

f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 18

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e parë

1. QKL-ja merr në shqyrtim kërkesat për grupin e parë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 2 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. QKL-ja shqyrton:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin, nëse është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;

b) plotësimin e plotë e të saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, të kërkuara në formular;

c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve të tjera shoqëruese, nëse kërkohen;

ç) përmbushjen apo jo të kriterëve, përkatësisht, të licencimit/autorizimit/lejimit;

d) pagesën e tarifës së shërbimit.

3. Shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve për grupin e parë, sipas shkronjës “ç” të pikës 2 të këtij neni, bazohet vetëm në vetëdeklarimin e kërkuarit.

4. QKL-ja refuzon kërkesën nëse:

a) personi, që ka paraqitur kërkesën, nuk është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë apo është e palexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;

ç) kërkuari nuk përmbush kriteret përkatëse të licencimit/autorizimit/lejimit;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së shërbimit.

5. Nëse rast të kundërt, QKL-ja e miraton kërkesën.

Neni 19

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e dytë

1. QKL-ja shqyrton, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, kërkesat për grupin e dytë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës. QKL-ja shqyrton edhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve provuese.

2. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit bazohet vetëm në vetëdeklarimet dhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

3. Refuzimi dhe miratimi i kërkesës bëhen për shkaqet, sipas pikave 4 e 5 të nenit 18 të këtij ligji.

4. Kërkesa refuzohet edhe nëse nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet provuese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, ose kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme.

Neni 20

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.

3. Nëse QKL-ja konstaton njërën nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.

4. Në rast të kundërt, QKL-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.

5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afatit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKL-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKL-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundërt QKL-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

Neni 21

Kombinimi i procedurave

1. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji nga apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejes bëhet për një pjesë të kriterëve që përpara fillimit të veprimtarisë, ndërsa vlerësimi i përmbushjes së pjesës tjetër të kriterëve bëhet vetëm pas një periudhe të caktuar të ushtrimit të veprimtarisë, trajtohen si më poshtë:

a) procedura kalon në këta dy hapa: licencë/autorizim/leje e përkohshme dhe licencë/autorizim/leje përfundimtare;

b) licenca/autorizimi/leja e përkohshme, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, është me afat të përcaktuar, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe titullari duhet të paraqesë kërkesën për pajisjen me licencën/autorizimin/lejen përfundimtare, përpara përfundimit të afatit të asaj të përkohshme.

2. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji, nga apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kushteve të licencimit/autorizimit/lejimit bëhet me dy hapa dhe në hapin e dytë shqyrtohet vetëm kërkesa e subjektit që ka kaluar me sukses hapin e parë, trajtohen si më poshtë:

a) procedura kalon në këta dy hapa: miratimi i kalimit me sukses të hapit të parë dhe licencimi/autorizimi/lejimi përfundimtar;

b) pas njoftimit nga QKL-ja të vendimit të miratimit për kalimin me sukses të hapit të parë, kërkuari duhet të paraqesë dokumentet shoqëruese për hapin e dytë brenda afatit përkatës.

3. Trajtimi i secilit prej hapave të parashikuar në shkronjën “a”, përkatësisht, të pikave 1 e 2 të këtij neni, u nënshtrohet, sipas rastit, procedurave të këtij ligji për grupin e parë, të dytë apo të tretë.

Këshilli i Ministrave përcakton grupin, sipas të cilit trajtohet secili hap.

Neni 22

Përmbajtja e vendimit dhe miratimi i heshtur

1. Vendimi i miratimit apo i refuzimit të kërkesës bëhet sipas formularit tip e njoftohet sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Vendimi i refuzimit përmban të gjitha shkaqet e refuzimit, ndërsa vendimi për miratim përmban edhe të dhënat e llogarinë bankare përkatëse, si dhe vlerën e taksës/tarifës që duhet paguar, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

3. Vendimi i refuzimit, i bërë sipas pikës 10 të nenit 20 të këtij ligji, përmban edhe vendimin, sipas formularit tip të institucionit tjetër që ka vendosur refuzimin.

4. Riparaqitja e kërkesës pas refuzimit trajtohet si kërkesë e re.

5. Në rastin kur QKL-ja, brenda afatit të përcaktuar, sipas këtij kreu, nga paraqitja e kërkesës, nuk publikon vendimin e refuzimit apo të miratimit, atëherë kërkesa quhet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në regjistër.

6. Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet për kërkesat për grupin e tretë nëse edhe vetëm njëri nga institucionet e tjera, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, ka vendosur refuzimin.

SEKSIONI 3

TITULLI I LICENCËS/AUTORIZIMIT/LEJES DHE LËSHIMI I TIJ

Neni 23

Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKL-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimi apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;

g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Neni 24

Hyrja në fuqi e licencës/autorizimit/lejes dhe prova e tij

1. Licenca, autorizimi apo leja hyn në fuqi menjëherë, me publikimin e titullit përkatës në regjistër, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Në rastet kur për përfitimin e titullit nuk është e zbatueshme një tarifë apo taksë, titulli publikohet në regjistër menjëherë dhe automatikisht, së bashku me njoftimin e vendimit të miratimit, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, apo menjëherë me gjenerimin e miratimit të heshtur, sipas pikës 5 të nenit 22 të këtij ligji dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKL-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri.

3. Në rastet kur për përfitimin e titullit është e zbatueshme një tarifë apo taksë:
- a) QKL-ja bën, menjëherë, shënimin përkatës në regjistër nëse kërkuesi paraqet dokumentin e pagesës së taksës/tarifës. Titulli publikohet automatikisht dhe menjëherë në regjistër dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKL-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri;
 - b) vendimi i miratimit, së bashku me dokumentin e pagesës së taksës/tarifës, zëvendësojnë titullin përkatës nëse QKL-ja nuk bën shënimin e pagesës së taksës/tarifës.
4. Nëse aplikohet një taksë apo tarifë dhe kërkuesi nuk paraqet provën e pagesës brenda afatit 30 ditë kalendarike nga publikimi i vendimit të miratimit, titulli vlerësohet automatikisht i revokuar dhe QKL-ja bën shënimin përkatës në regjistër, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Neni 25

Zëvendësimi i titullit

1. Në rast humbjeje apo dëmtimi të titullit, titullari njofton QKL-në dhe i kërkon zëvendësimin e titullit. Kërkesa bëhet sipas procedurave të këtij ligji dhe formularit të miratuar.
2. QKL-ja anulon titullin dhe e zëvendëson atë brenda 2 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, duke bërë edhe shënimin përkatës në regjistër.

SEKSIONI 4

NDRYSHIMET, SHTYRJA E AFATIT DHE REVOKIMI

Neni 26

Ndryshimi i të dhënave të titullit, që nuk kanë të bëjnë me kriteret

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë, veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titull e të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim i njoftohet, brenda 30 ditëve, QKL-së, me kërkesë të titullarit.
2. Kërkesa bëhet sipas procedurave të përcaktuara për grupin e parë dhe duhet të përmbajë të dhënat e reja, që kërkohen të ndryshohen.
3. Kur QKL-ja vëren se ka të bëjë me një rast të tillë, bën ndryshimet përkatëse dhe lëshon titullin e ndryshuar brenda 2 ditëve nga data e bërjes së kërkesës.

Neni 27

Ndryshimi i të dhënave të titullit, që kanë të bëjnë me kriteret

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë, veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin përkatës e të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim, pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kritere, duhet t'u njoftohet nga titullari i titullit, menjëherë QKL-së dhe institucioneve të tjera përkatëse, që kanë marrë pjesë në dhënien e atij titulli. Kur ndryshimet janë të tilla, që mund të cenojnë kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, titullari duhet të pezullojë, me nismën e vet, veprimtarinë, veprimin apo përdorimin e së mirës publike.
2. Titullari duhet të kërkojë verifikimin, nëse këto ndryshime çojnë në vazhdimin e vlefshmërisë së titullit me ndryshimet përkatëse apo në revokimin e tij.
3. Kërkesa për të dhënat që ndryshojnë bëhet sipas nenit 17 të këtij ligji dhe shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, sipas të njëjtit grup, për të cilin është bërë kërkesa për vetë titullin.
4. Kur vlerësohet se ndryshimet e ndodhura nuk cenojnë kriteret, titullari pajiset me titullin e ndryshuar, afati i vlefshmërisë së të cilit mbaron në të njëjtën datë me atë të titullit të mëparshëm.
5. Kur vlerësohet, sipas këtij ligji, se ndryshimet e ndodhura cenojnë kriteret, titulli revokohet.

Neni 28

Shtyrja e afatit të licencës/autorizimit/lejes

1. Shtyrja e afatit të titullit është e mundur vetëm kur është parashikuar në legjislacionin e posaçëm dhe vetëm në bazë të kushteve të parashikuara në të.
2. Kërkesa për shtyrjen e afatit trajtohet e shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, e të njëjtit grup,

sipas këtij ligji.

Neni 29

Revokimi i licencës/autorizimit/lejes

1. Titujt e lëshuar, sipas këtij kreu, revokohen sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.
2. Titulli revokohet edhe nga QKL-ja në këto raste:
 - a) me kërkesë të titullarit;
 - b) për mospagim të taksës/tarifës përkatëse (nëse ka);
 - c) për konstatim të të dhënave të pavërteta në dokumentet e paraqitura në QKL;
 - ç) për mosnjohim të ndryshimit të të dhënave, sipas nenit 26 apo 27 të këtij ligji.
3. QKL-ja merr vendimin për revokimin e titullit në afatin e 2 ditëve pune nga përcaktimi i shkaqeve të revokimit.
4. Në rastin e revokimit të titullit, taksa/tarifa e paguar nuk kthehet.

SEKSIONI 5

ANKIMI

Neni 30

Ankimi

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKL-së apo institucionit tjetër në rastin e grupit të tretë.
2. Ankimi administrativ shqyrtohet nga titullari i QKL-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.
3. Në rastin e refuzimit të parashikuar në pikën 10 të nenit 20 të këtij ligji, ankimi shqyrtohet nga institucioni tjetër, që e ka vendosur refuzimin.
4. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet me kërkesë në QKL, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, QKL-ja publikon ankimin dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionin tjetër kompetent.
5. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mosveprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI 6

MËNYRAT E PARAQITJES SË KËRKESAVE E NJOFTIMEVE NË DHE NGA QKL-JA, PUBLIKIMET DHE MIRATIMI I AKTEVE TË TJERA NËNLIGJORE

Neni 31

Paraqitja e kërkesave në QKL

Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës në QKL mund të kryhen nëpërmjet:

- a) paraqitjes drejtpërdrejt në çdo sportel shërbimi të QKL-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuarit;
- b) dërgimit me postë me lajmërim-marrje në selinë qendrore të QKL-së;
- c) dërgimit me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

Neni 32

Paraqitja në sportelet e QKL-së

1. Kërkesa paraqitet në sportelin e QKL-së nga vetë kërkuari apo çdo person i autorizuar prej tij.
2. Nëpunësi i sportelit asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të kërkesës, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar.

3. Dokumentet shoqëruese paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin apo në kopje të shoqëruara me origjinalin, që njësohen me origjinalin nga nëpunësi i sportelit.

4. Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.

5. Nëpunësi i sportelit lëshon një konfirmim, me shkrim, për çdo kërkesë. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë llojin e kërkesës, datën dhe listën e dokumenteve shoqëruese të dorëzuara.

6. Nëpunësi i sportelit është i detyruar të marrë në dorëzim çdo kërkesë të paraqitur, sipas këtij ligji, edhe nëse kërkesa është e paplotë.

7. Dokumenti i pagesës së tarifës/taksës paraqitet në sportel, nëpunësi i të cilit lëshon një konfirmim me shkrim.

Neni 33

Paraqitja me postë

1. Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës së licencës/autorizimit/lejes në QKL mund të kryhen edhe me postë me lajmërim-marrje.

2. Formulari i plotësuar i kërkesës/njoftimit, në rastin e paraqitjes me postë, nënshkruhet nga personat përgjegjës, për përfaqësimin e personit juridik apo vetë personi fizik.

3. Dokumentet bashkëlidhur paraqiten në kopje të njësuara me origjinalin.

4. Bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe një kopje e dokumentit të identifikimit të personit që ka nënshkruar formularin.

5. Në bazë të marrëveshjes me organet e shërbimit postar, nëpunësi i shërbimit postar lëshon konfirmimin, sipas pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

6. Data e paraqitjes së kërkesës në QKL është data e përcaktuar në lajmërim-marrje.

Neni 34

Njoftimi i vendimeve nga QKL-ja dhe dorëzimi i titullit

1. Vendimet e QKL-së, sipas këtij ligji, njoftohen nëpërmjet publikimit në regjistër.

2. Data e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është data e publikimit në regjistër.

3. Titulli përkatës i dorëzohet kërkuar në sportel.

Neni 35

Afati i publikimi në regjistër

Çdo kërkesë dhe çdo vendim i QKL-së apo i një institucioni tjetër, që lidhet me licencimin/autorizimin/lejimin, sipas këtij kreu, publikohet në regjistër brenda ditës së nesërme të punës nga paraqitja e kërkesës apo marrja e vendimit ose e bërjes me dije.

Neni 36

Miratimi i procedurave dhe i formateve standarde

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton:

a) procedurat e hollësishme të trajtimit të kërkesave të licencave/autorizimeve/lejeve dhe të nënkategorive të tyre;

b) kriteret e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategoritë, dokumentet shoqërues, formën dhe përmbajtjen e dokumenteve shoqëruese, si dhe afatin e vlefshmërisë së titullit përkatës;

c) detyrimet e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategoritë të tyre, sipas delegimit nga legjislacioni përkatës i posaçëm;

ç) institucionet e tjera kompetente, që vlerësojnë përmbushjen e kriterëve, sipas pikës 5 të

nenit 20 të këtij ligji, si dhe metodat e afatet përkatëse;

d) aktet e tjera nënligjore, të përcaktuara në këtë kre.

2. Ministri, së bashku me ministrin përgjegjës miratojnë:

a) formularët e kërkesave me përmbajtjen e hollësishme të rubrikave të tyre, për çdo kategori e nënkategori të licencave/autorizimeve/lejeve;

b) formularët për titujt e licencave/autorizimeve/lejeve dhe të anekseve përkatëse.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKL-së, miraton formularët për llojet e tjera të kërkesave, të njoftimeve që bëhen në QKL, sipas këtij ligji, si dhe ato të vendimeve të QKL-së.

KREU VI

KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QKL-SË

Neni 37

Krijimi dhe statusi

1. Krijohet Qendra Kombëtare e Licencimit.

2. QKL-ja është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit, me seli në Tiranë.

3. QKL-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

4. QKL-ja ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për funksionet e veta, të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji.

Neni 38

Funksionet e QKL-së

QKL-ja ka këto funksione:

a) trajton procedurat e licencimit/autorizimit/lejeve, ndryshimit dhe revokimit, sipas këtij ligji;

b) mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave e Lejeve;

c) siguron aksesin e lirë të publikut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) informon dhe këshillon kërkuarësit dhe publikun për procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;

e) jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e licencave/autorizimeve/lejeve;

dh) kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla institucionet qendrore dhe të pavarura, për nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e licencave, autorizimeve e lejeve dhe ministrinë dhe/ose Këshillin e Ministrave në politikën për përmirësimin e mjedisit rregullator.

Neni 39

Organizimi i QKL-së

1. QKL-ja është institucion unik dhe ushtron juridiksionin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. QKL-ja ofron shërbimin ndaj publikut, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me sportelet në selinë e saj, sportelet e shërbimit të krijuara në territor, sportelet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore apo në institucione e ente të tjera, publike apo private.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, ku krijohen dhe funksionojnë shërbimet e sportelit, përcaktohen nga QKL-ja dhe janë të detyruara të krijojnë sportelet, sipas këtij ligji.

4. Në njësitë e qeverisjes vendore, përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni, shërbimi i sportelit kryhet si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligj dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

5. Ngritja e sporteleve në institucionet dhe entet e tjera publike apo private bëhet nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse me QKL-në, pas miratimit paraprak të ministrit.

Neni 40
Drejtimi i QKL-së

1. Veprimtaria e QKL-së drejtohet nga titullari.
2. Titullari është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKL-së.
3. Titullari përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.
4. Titullari i QKL-së ushtron udhëheqjen metodologjike dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për nëpunësit e QKL-së, si dhe për nëpunësit e sporteleve të shërbimit, për ushtrimin e funksionit të deleguar.

Neni 41
Numri i punonjësve dhe struktura e QKL-së

1. Numri i punonjësve të QKL-së miratohet nga Këshilli i Ministrave, si zë më vete, në përputhje me ligjin për Buxhetin vjetor të Shtetit.
2. Struktura dhe organika e QKL-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 42
Statusi i titullarit të QKL-së

1. Titullari i QKL-së emërohet nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Titullari i QKL-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
3. Titullari i QKL-së lirohet nga detyra për shkaqet dhe sipas procedurave të parashikuara në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Vendimi për lirim të titullarit merret nga ministri.
4. Titullari i QKL-së i nënshtrohet dispozitave që rregullojnë masat, procedurat disiplinore dhe vlerësimin e punës, sipas parashikimeve në legjislacionin për nëpunësin civil. Ministri është “epriori direkt”, në kuptimin e këtyre dispozitave.
5. Kundër vendimit të ministrit për aktet e nxjerra në bazë të pikave 1 deri në 4 të këtij neni, ankimi bëhet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente.

Neni 43
Nëpunësit dhe punonjësit e QKL-së

1. Për nëpunësit e QKL-së zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. Titullari i QKL-së është “epriori direkt”, në përputhje me këto dispozita.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të QKL-së, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.
3. Ankimi ndaj akteve të titullarit, të nxjerra në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 44
Nëpunësit e sporteleve në njësitë e qeverisjes vendore

1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore, ku ato krijohen, janë nëpunës të njërive vendore përkatëse.
2. Njësia e qeverisjes vendore përkatëse cakton nëpunësin e sportelit pas miratimit paraprak të titullarit të QKL-së. Miratimi paraprak jepet jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së propozimeve nga njësia vendore.
3. Titullari i QKL-së përcakton kriteret e posaçme profesionale, që duhet të plotësojnë këta nëpunës dhe siguron trajnimin profesional të tyre, për kryerjen e funksionit të deleguar, sipas këtij

ligji.

4. Titullari i QKL-së kërkon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën, sipas treguesve të cilësisë të QKL-së.

5. Njësia e qeverisjes vendore është e detyruar ta zëvendësojë nëpunësin e sportelit menjëherë pas kërkesës së titullarit të QKL-së.

Neni 45

Pagat e QKL-së

1. Struktura dhe nivelet e pagave dhe të shpërblimit të QKL-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve në sportelet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore përcaktohen nga këshillat përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 46

Buxheti i QKL-së

1. Buxheti i QKL-së është zë më vete në Buxhetin e Shtetit.

2. Projektbuxheti vjetor dhe afatmesëm i QKL-së përgatitet nga titullari i saj dhe propozohet pas miratimit nga ministri.

3. Buxheti përbëhet nga të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e QKL-së, përfshirë edhe fondet për shpenzime operative dhe kapitale për sportelet e shërbimit dhe të ardhurat, që krijohen në këto sportele.

4. Fondet për shpenzime operative, për çdo sportel, në njësinë e qeverisjes vendore, janë fonde të kushtëzuara. Ato përcaktohen në buxhetin e QKL-së, bazuar në kritere të drejta e objektive, në përputhje me vlerësimin paraprak të ngarkesës operative të çdo sporteli dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit dhe i jepen njësisë përkatëse në formën e një shume totale të kushtëzuar.

5. Shpenzimet kapitale për pajisjet në sportelet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore kryhen nga QKL-ja.

6. Njësia e qeverisjes vendore, në përputhje me objektivin e saj, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve të sportelit.

Neni 47

Shërbimet e tarifat e QKL-së

1. QKL-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera, në mbështetje të këtyre funksioneve.

2. Ministri përcakton shërbimet e tjera, që ofrohen nga QKL-ja, tarifatat e të cilave miratohen, me propozimin e tij, nga Ministri i Financave.

3. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet, që lidhen me kryerjen e detyrave funksionale, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

4. Të gjitha tarifatat shpallen në çdo sportel shërbimi dhe në faqen e internetit të QKL-së.

Neni 48

Përdorimi i të ardhurave të veta nga QKL-ja

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifatat për kryerjen e funksioneve, sipas këtij ligji, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e shërbimit, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Të ardhurat nga tarifatat për shërbimet e tjera, të krijuara nga QKL-ja ose nga sportelet e shërbimit, derdhen vetëm në masën 90 për qind në Buxhetin e Shtetit, ndërsa 10 për qind përdoret nga QKL-ja për përmirësimin e funksionimit e të shërbimit të QKL-së.

3. QKL-ja mban llogaritë në thesar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 49

Auditimi i QKL-së

Veprimtaria financiare e QKL-së auditohet nga strukturat e ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Raportimi dhe përgjegjshmëria

1. Ministri miraton objektivat specifike të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen QKL-ja dhe mbikëqyr arritjen e tyre.

2. QKL-ja i raporton ministrit për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit.

Neni 51

Statuti i QKL-së

Këshilli i Ministrave, në përputhje me parimet e këtij ligji, me propozimin e ministrit, miraton statutin e QKL-së, që përfshin rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e saj, ndarjen dhe organizmin e punës, statusin e punonjësve, mënyrën e raportimit, marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe lidhjen e marrëveshjeve për sportelet e shërbimit.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

HYRJA NË FUQI

Neni 52

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në të gjitha ligjet e tjera, për aq sa është e nevojshme, për sigurimin e koherencës ligjore me këtë ligj dhe t'ia paraqesë ato Kuvendit në trajtën e një pakete të vetme.

2. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministri dhe ministri përgjegjës që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.

3. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministrat dhe organet e tjera që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të posaçme, të miratojnë akte normative nënligjore në fushën e lejeve, të autorizimeve dhe licencave dhe të përshtatin aktet nënligjore, sipas rastit, në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 53

Dispozita kalimtare

1. Licencat/autorizimet/lejet kompetencë e institucioneve qendrore, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin, për të cilin janë lëshuar.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore, që kanë lëshuar licenca/autorizime/leje deri në afatin e parashikuar në pikën 2 të nenit 55 të këtij ligji e që të cilat, sipas këtij ligj, trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, t'i dërgojnë QKL-së të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave e Lejeve, brenda këtij afati.

3. Ngarkohen të gjitha institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, të publikojnë, brenda datës 31 dhjetor 2009, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për licencat/autorizimet/lejet e vlefshme e të dhëna prej tyre deri në këtë datë.

4. Deri në bërjen funksional të sistemit elektronik të komunikimit me QKL-në, për grupin e tretë të licencave/autorizimeve/lejeve, afateve të parashikuara për:

a) publikimin e vendimit paraprak nga QKL-ja, sipas pikës 4 të nenit 20 të këtij ligji;

b) publikimin e vendimit të institucionit tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji;

t'u shtohen, përkatësisht, nga 2 ditë kalendarike për dërgimin/marrjen e vendimit me postë me lajmërim-marrje.

Neni 54
Shfuqizime

Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 55
Fillimi i efekteve

1. Krerët I, II, IV, VI e VII i shtrijnë efektet menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. QKL-ja fillon trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, në përputhje me këtë ligj dhe kreun V të tij, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por jo më vonë se data 31.5.2009.
3. Institucionet qendrore kompetente për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, sipas legjislationit përkatës, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të pranojnë kërkesa dhe t'i trajtojnë ato deri në datën e fillimit të trajtimit nga QKL-ja, sipas pikës 2 të këtij neni. Kërkesat në proces dhe të papërfunduara deri në këtë datë trajtohen nga institucionet përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi tërheq kërkesën dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKL-së.
4. Kreu III i shtrin efektet për institucionet pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, në datën 31 dhjetor 2009.

Neni 56
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6088, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Shtojce e ligjit “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

Nr.	Nr. i fushës/kategorisë	Lloji i	Fusha/Kategoritë
-----	-------------------------	---------	------------------

		kategorisë	E veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre
	Fusha I		Siguria Kombëtare, Rendi publik dhe Mbrojtja Civile
1	1.	Licence	Prodhimin dhe/ose tregtimin i mallrave (armë, municione, lëndë, pajisje, teknologji etj) ushtarake dhe/ose me përdorim të dyfishtë
2	2.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile
3	3.	Licence	Shërbimi i ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike
	Fusha II.		Ushqimi dhe Shëndeti
4	1.	Licence	Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
5	2.	Licence	Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare
6	3	Licence	Rritja ose tregtimi i kafshëve
7	4.	Licence	Prodhimi dhe/ose tregtimi i farevave dhe/ose fidaneve
8	5.	Licence	Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimeve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
9	6.	Licence	Shërbime mjeksore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
10	7.	Licence	Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
11	8.	Licence	Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjienosanitare
	Fusha III.		Mjedisi dhe burime mjedisore bazë.
12	1.	Leje	Për ndikimin në mjedis
13	2.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
14	3.	Licence	Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese
15	4.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose kultivimi i florës (tokësore dhe/ose ujore)
16	5.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose mbarështrimi i faunës (tokësore ose ujore)
17	6.	Leje	Shfrytëzimi i ujrave mbi dhe/ose nën/tokësore dhe/ose baseneve e materialeve të tyre
18.	7	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë
	Fusha IV.		Burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike
19	1.	Leje	Minerare ose hidrokarbure
20	2.	Leje	Për të gjitha rastet që burojnë nga legjislacioni për koncensionet
21	3.	Leje	Rastet dhe llojet e tjera të përdorimit të burimeve me natyrë energjetike.
22.	4.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe.
	Fusha V.		Territori dhe ndërtimi
23	1.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me zhvillim e territorit dhe/ose ndërtimin
24	2.	Leje	Zhvillimi territorial dhe/ose ndërtimor
	Fusha VI.		Trashëgimia kulturore
25	1.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me trashëgiminë kulturore
26	3.	Leje	Restaurim dhe/ose Rijetëzimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore
27	4.	Licence	Administrimin kolektiv i të drejtave të autorit
	Fusha VII.		Transporti
28	1.	Licence	Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve
29	2.	Licence	Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të trete
30	3.	Licence	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor
31	4.	Licence	Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose udhëtarëve
32	5.	Licence	Për shërbime portuale
33	6.	Licence	Për shërbime hekurudhorre
34	7.	Licence	Për shërbime aeroportuale
	Fusha VIII.		Industri dhe Shërbime të tjera
35	1.	Licence	Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri
	Fusha IX.		Arsimi dhe shkenca
36	1.	Licence	Arsimi parauniversitar
37	2.	Licence	Arsimi i lartë
	Fusha X.		Kujdesit Shogëror dhe Punësimit
38	1.	Licence	Shërbime të kujdesit shogëror
39	2.	Licence	Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit profesional
	Fusha XI.		Drejtësia dhe ligji
40	1.	Licence	Shërbimi i Noterisë
41	2.	Licence	Shërbimi i Përmbarimit
42	3.	Licence	Shërbime të tjera ekspertize ose profesionale të lidhura me të drejtat civile dhe/ose penale

	Fusha XII.		Financat publike
43	1.	Licence	Për trajtime të favorizuara fiskale dhe/ose doganore
44	2.	Licence	Shërbime ekspertize ose profesionale financiare apo shërbime të lidhura me financat publike
45	3.	Licence	Organizimi i lojrave të fatit.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.3.2009
Doli nga shtypi më 25.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë